



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 MARS 2019, ora 11:00**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. MARTA 2019. GODINE, 11:00 časova**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës 3-javore, prej 14 janar - 1 shkurt 2019

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o nastaloj situaciji u obrazovanju nakon odluke USONK-a za odbijanje naknade izgubljenih časova tokom 3 nedelje štrajka, od 14. januara do 1. februara 2019. godine

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Jemi në pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar për situatën e krijuar në arsim pas vendimit të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës 3-javore, prej datës 14 janar deri më 1 shkurt 2019

Të nderuar deputetë,

42 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura, përkatësisht së paku 15 njësi mësimore gjatë grevës trejavore nga 14 janari deri më 1 shkurt 2019.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar, Bilall Sherifi, që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Zoti Kurteshi, urdhëro, deri të vijë Bilalli!

ISMAJL KURTESHI: Edhe dita është e jashtëzakonshme.

Sot është përvjetori i masakrës së Izbicës dhe masakrës së Podujevës. Ju kisha lutur që të kërkonti një minutë heshtje, pastaj fillojmë punën.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi!

Kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për nderim të martirëve të rënë në këto dy masakra të ngrihemi në këmbë për një minutë heshtje.

Nderim!

Faleminderit! Zoti Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar nxënës,

Të nderuar mësues dhe mësuese,
Mësimdhënës, në përgjithësi, të Republikës së Kosovës,
Sot kemi ftuar një seancë në emër të 42 deputetëve nënshkrues të seancës së jashtëzakonshme për të diskutuar, për të debatuar për çështjen e orëve të mësimit të humbura gjatë grevës trejavore.

Ideja e thirrjes së kësaj seance erdhi si rezultat i mospranimit që këto orë të mësimit të zëvendësohen me ditë të tjera, siç janë paraparë sipas plan-programit arsimor.

Pra, nëse debati është duke u zhvilluar gjithandej Kosovës, nëpër studio televizive, nëpër kafene, nëpër salla të arsimitarëve, nëpër shtëpi të prindërve, nëpër vende të ndryshme, atëherë pse të mos zhvillohet një debat edhe në Kuvendin e Kosovës nga deputetët e Kuvendit të Republikës sonë, se çka është duke ndodhur me këtë çështje.

Nuk dua këtu të zgjeroj debatin në nivelin e arsimit në përgjithësi, por të kufizojmë në çështjen e thirrur nga 42 deputetë.

Pra, nuk është ideja këtu që të linçojmë askënd, as të luftojmë askënd, as të shpallim armik të arsimit askënd, as mik të arsimit dikë tjetër, por të shprehim shqetësimin tonë se si të dalim nga kjo gjendje, se si të mos pranojmë që orët e mësimit të trajtohen njëjtë sikur orët e humbura në një fabrikë të suxhukut, sikur orët e humbura gjatë grevës në një fabrikë të betonit apo ku ta di unë çfarë aktivitete të tjera punuese.

Orët e mësimit janë njësi mësimore, orët e mësimit nuk janë orë pune thjesht, por çdo orë mësimi është një njësi mësimore, është një orë përsëritje të mësimit të mësuar, është një orë e pyetjes të nxënësve se sa e kanë kuptuar dhe sa e kanë mësuar mësimin që është shpjeguar nga mësuesi, nga arsimtari.

Pra, nëse ndalemi thjesht në atë që ta trajtojmë se është ora e humbur e drejtë sindikale që të mos kompensohet asnjëherë, unë mendoj që është qasje e gabuar, sepse kjo nuk duhet të ndodhë me arsimin, nuk duhet të ndodhë me orët në arsim dhe unë jam i sigurt që të gjithë arsimitarët, edhe ata që janë në SBASHK, në Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, edhe ata e dinë që nuk mund të trajtohet njëjtë.

Pra, le ta trajtojmë seriozisht këtë çështje dhe të kuptojmë se nuk është njëjtë sikur 15 njësi mësimore të mungojnë gjatë procesit të arsimit dhe në fund nxënësi i klasës së parë të ketë vështirësi në mësimin e germave, klasës së dytë, siç e keni parë në arsyetim të kenë vështirësi në tabelën e shumëzimit, e klasës së pestë, të gjashtë e kështu me radhë, madje semimaturantët dhe maturantët të kenë vështirësi në testin përfundimtar, sepse nëse ato njësi mësimore nuk kompensohen, unë nuk do të flas me gjuhën e orëve, siç është bërë zakon të flitet, kemi të drejtë

apo nuk kemi të drejtë, a mund t'i detyrohet dikush apo nuk mund t'i detyrojë dikush të kompensohen orët.

Pra, unë nuk dua ta barazoj orën e mësimit, nuk pranoj, së paku unë, që orën e mësimit ta barazoj me orën e punës në një fabrikë.

Nëse 15 njësi mësimi refuzohen të shpjegohen, duhet gjithsesi në testin e paraparë qoftë për semimaturantët, qoftë për maturantët, të hiqen këto 15 njësi mësimore, sepse nxënësit, të cilin e ke privuar nga shpjegimi i atyre mësimeve, nuk mundesh pastaj në fund ta pyesësh se a i di apo nuk i di, sepse nëse do të ishte kështu, atëherë nuk do të kishim nevojë për shkolla, veç thjesht do t'i shpërndanim librat nëpër shtëpi, do t'i mësonin nxënësit dhe nxënëset vetë mësimit dhe në fund të vitit do të shkonin për t'u notuar apo për t'u testuar se sa kanë arritur t'i mësojnë mësimit, të cilat i kanë mësuar vetë nëpër libra.

Pra, kjo ka pasoja, nëse nuk zëvendësohen mësimit, nuk mund t'i pyesësh, nuk mund t'i ndëshkosh, as nuk mund t'i dënosh për atë që nuk e kanë pasur mundësinë ta marrin atë dije, atë shpjegim nga arsimtarët.

Pra, këtu ose kurrikula duhet të plotësohet në tërësi, duke filluar nga shpjegimi, mësimi dhe testimi pastaj, ose duhet të hiqen. Ne mendojmë që duhet të hiqen ato njësi mësimore, të mos ligjërohen fare, të mos shpjegohen fare, në rregull.

Nëse SBASHK-u, i cili insiston që kjo çështje të trajtohet si çështje sindikale, jo si detyrim moral kushtetues dhe ligjor që kanë për t'i shpjeguar mësimit, për t'i pajisur nxënësit me dije, atëherë është interpretimi i tyre. Unë nuk dua të lëshohem në të, po mendoj që është i gabuar.

Prandaj, kjo seancë ka për qëllim që nga debati të dalim me rekomandime, qoftë për propozim rezolutë, qoftë si deklaratë, se si e sheh dhe çka duhet të ndërmerret në të ardhmen, si e sheh Kuvendi, pra deputetët, pjesëmarrës në debat dhe deputetët në fund që do të votojnë.

Unë do ta lexoj këtu një propozim-rezolutë dhe pres që gjatë zhvillimit të debatit, ju kolegë të nderuar, qoftë përmes shefave të grupeve parlamentare, qoftë vetë të sillni ndonjë propozim se çka do të ishte mirë të përfshihej në rezolutë, të cilën unë në emër të 42 deputetëve nuk kam arritur ta përfshij.

“Greva 3-javore në arsim të këtij viti ka pasur për pasojë humbjen e shumë orëve të mësimit. Rrjedhimisht, edhe të shumë njësive mësimore të parapara me plan-program të Ministrisë së Arsimit.

Kuvendi i Kosovës konsideron që plotësimi i plan-programit arsimor, i paraparë nga Ministria e Arsimit, është i domosdoshëm.

Kuvendi i Kosovës kërkon nga Ministria e Arsimit, SBASHK-u dhe drejtorët e Drejtorive Komunale për Arsim që urgjentisht, brenda javës së ardhshme, të gjejnë mënyrën për të mbajtur orët mësimore të humbura gjatë grevës së këtij viti”.

Pra, siç e shihni, propozimi nuk ka për qëllim të mbajë anën e askujt, pos anën e nxënësve.

Propozimi që del nga ne ka për qëllim ofrimin e dorës të gjithë aktorëve që janë të përfshirë dhe që fatkeqësisht më shumë janë duke dominuar inatet, se sa arsyeja. Pra, t’i thërrasim arsyes dhe të gjitha palët të ulen javën e ardhshme, urgjentisht, të gjejnë një zgjidhje se si të zëvendësohen, po e përsërisë, refuzoj t’i quaj orë se si të zëvendësohen ato njësi mësimore, se si të gjendet mënyra të shpjegohen njësitë mësimore, të cilat janë humbur, sepse nëse nuk jua shpjegojmë, nëse gjatë vitit nuk i pyesim a i kanë mësuar, në fund nuk kemi të drejtë as t’i testojmë dhe as t’i ndëshkojmë për atë që nuk ua kemi ligjruar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sherifi! Fjalën e ka kryetari i Parlamentit që edhe e ka pasur një takim shtesë për shkak të kësaj me Sindikatat e Arsimit dhe mund t’i ndihmojë procesit.

KRYETARI KADRI VESELI: Faleminderit!

Unë e falënderoj zotin Sherifi për iniciativën dhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Më lejoni të përshëndes edhe ministrin e Arsimit, i cili është duke bërë një punë shumë të mirë.

Për korrektësinë e drejtimit të kësaj seance të jashtëzakonshme, desha të bëj vetëm një informacion, ku gjatë kohës së fundit kam pasur si kryetar i Kuvendit, pas disa kërkesave, qoftë nga disa shkolla në takime, qoftë edhe nga prindër, kam iniciuar disa takime, të cilat kanë qenë dypalëshe, dy herë, me Ministrinë e Arsimit, po ashtu edhe me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit. Ka një klimë shumë pozitive për t’u tejkaluar kjo situatë.

Do të thotë, për atë arsye unë do të dal, duke mos e mohuar atë pjesën çka iniciuesi e përmendi. Unë kisha pasur dëshirë që mbas kësaj seance Kuvendi i Republikës së Kosovës ta autorizojë Komisionin tonë Parlamentar për Arsim, dhe besoj se për çështje takimit njëorësh kjo çështje përfundon, për vetë faktin se qoftë ministri i Arsimit është shumë i hapur në opsionin e tejkalimit të kësaj situatë, për arsye se i ka mbetur si situatë në dorë, është nevoja të kompensohen ato orë, por qoftë Sindikata e Bashkuar e Arsimit në aspektin ligjor, që e konsideron të drejtën e vet në çështjen e grevës, ka një gatishmëri që të bartet në pjesën, jo në këtë, të jem më konkret, në

çështjet të cilat janë biseduar, po Komisioni për Arsim në qoftë se ju e autorizoni, atëherë do ta arrinte shumë shpejt këtë marrëveshje që orët e humbura të mësimit të kompensohen në pjesën e fundit të vitit shkollor.

Edhe ministria është e hapur në këtë propozim, ja ku është edhe ministri, po edhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, të mendohet më së shumti për nxënësit.

Këtë desha ta them, seanca është e jashtëzakonshme, e merr rrjedhën e vet, sido që të jetë, nuk është mirë të dramatizohet situata, e cila mund të zgjidhet besoj shumë që Komisioni i Arsimit, si komision t'i takojë për një kohë të shumë të shkurtër, për një orë e arrin një marrëveshje dhe i largojmë nga ankthi shumë prindër për pushimet pranverore që janë shumë shpejt.

Kjo ishte vetëm sa për njoftimin e kolegëve deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën për të sqaruar rreth kësaj çështje. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mësimdhënës,

Të dashur nxënës,

Të nderuar qytetarë,

Kjo seancë e jashtëzakonshme, bazuar në gjendjen që po krijohet, është më se e qëlluar, vetëm sa për informim, atë që e theksoi kryetari, ne dje kemi pasur një kërkesë përmes këshilltarit të kryetarit që të kemi takim me SBASHK-un dhe jemi dakorduar që pas seancës ne jemi të gatshëm të takohemi dhe të diskutojmë, sepse gjithmonë kemi qenë të hapur të diskutojmë e të gjejmë zgjidhje në të mirën e nxënësve.

Plotësimi i orëve të humbura si pasojë e grevës së punëtorëve në arsim po bëhet një sfidë në vete. Kohë më parë ne u ballafaquam me grevën e punëtorëve të arsimit, të organizuar dhe drejtuar nga SBASHK-u. U desh kohë dhe angazhim të shumë faktorëve për të arritur një marrëveshje që arsimit t'i kthehej normalitetit. Marrëveshja ktheu në punë grevistët dhe risolli në proces mësimor nxënësit e studentët, por nuk e ktheu humbjen që pësoi mosrealizimi i programit mësimor në orët e humbura. Sindikata e Punëtorëve të Arsimit mori një marrëveshje përmes një greve të gjatë, ne Qeveria, morëm mirëkuptimin e SBASHK-ut dhe funksionimin e procesit të arsimit, por nxënësit çfarë morën? Ata rrezikohen të bëhen humbësit më të mëdhenj pa fajin e tyre. Greva e punonjësve të arsimit, e drejtuar nga SBASHK-u, kohë më parë, edhe pse e drejtë ligjore dhe mekanizëm i pranuar demokratik, ka shkaktuar pasoja për faktorin më të rëndësishëm të sistemit arsimor, atë të shkollarëve.

Grevistët, sikurse dhe jemi shprehur që në fillim të grevës, kanë qenë në të drejtën e tyre. Jam takuar, jam solidarizuar me ta, por vazhdimisht e kam theksuar dhe kam kërkuar që të kemi kujdes të shtuar që të mos dëmtohen nxënësit. Kam kërkuar mirëkuptim nga SBASHK-u që në vazhdimësi të kërkojmë zgjidhje, meqë edhe unë isha vënë komplet në anën e tyre vetëm e vetëm që mësimi të mos ndërpritej. Këtë mirëkuptim nuk e gjeta tek ata, më vjen keq për këtë. Kam pritur ndjeshmëri më të madhe të tyre për humbjen që po u shkaktohej nxënësve e studentëve, ngase unë kam qenë për gjatë gjithë atyre zhvillimeve të hapur me ta, sikurse edhe konsulta për harmonizimin me kryeministrin, ministrin, deputetët, palët që kishin të bënin me zgjidhjen që u ofruam. Mosrealizimi i programit mësimor është cilësi e munguar dhe kjo cilësi e munguar po na dëmton në të gjitha anët dhe të gjitha palët, qoftë për arritshmëri, qoftë për standarde. Edhe sot e kësaj dite mendoj se nuk bëjmë mjaftueshëm për arsimin e marrëveshjen që e ndërpreu grevën, do të doja të bëhej shumë më shumë, por ato ishin mundësitë. Ligji për grevat u jep të drejtë grevistëve për të mos vuajtur pasojat e veprimit grevist, por jam i sigurt se asnjë mësimdhënës nuk e konsideron pasojën e ofrimit të dijes për fëmijët tanë. Në mes të këtij raporti Qeveri – SBASHK, pra ekziston edhe një palë interesi dhe ajo më e rëndësishmja e gjithë procesit të nesërme sonë janë shkollarët tanë, janë nxënësit tanë, janë fëmijët e të gjithë neve dhe po ashtu, e përbashkëta jonë. Jemi qeveritarë, sindikalistë, mësimdhënës a profesione të tjera, e përbashkëta jonë është se ne të gjithë jemi prindër.

Të nderuar deputetë,

Unë kam lëshuar një vendim të dakorduar plotësisht me DKA-të për plotësimin e orëve të humbura në bazë të ligjit në fuqi që obligon MASHT-in për harmonizimin e kalendarit të vitit shkollor që t'u mundësojë DKA-ve që në ekzekutimin e këtij vendimi të përmbushet norma e paraparë. Kjo ka indinjuar SBASHK-un, i cili tashmë kërcënon me greva të tjera, nëse ne do të mbesim në vendimin tonë. Mosrealizimi i programit mësimor prodhon cilësi të munguar, dije të munguar që do të thotë, shkronja të papërvetësuara nga nxënësit e klasës së parë, shumë njësi të pamësuar nga nxënësit e tjerë, mungesë më të dobët të testi i arritshmërisë, një test mature me suksese të munguara për maturantët dhe tërë kjo është një kosto, të cilët do ta paguajmë të gjithë ne si shoqëri. Në asnjë mënyrë nuk besoj se mësuesit mund të dëmtojnë nxënësin duke privuar nga njësia e programeve mësimore. Ky privim rrezikon të thellohet në dëm të shkollarëve, sepse SBASHK-u tash po e sheh çështjen thjesht një dimensionin e dinjitetit vetjak, krahas masave që përfaqëson. Tash ne jemi në një rrethanë jo të mirë, ambiciet tona për arritshmëri dhe cilësi nuk mund të përmbushen duke mosrealizuar programin mësimor.

Arsimi nuk është vend ku kushdo nga palët do të duhej t'i tregojë muskujt, si drejtues i dikasterit të arsimit, unë nuk do të mund të pajtohem asnjëherë për të quajtur të mbyllur vitin shkollor në program mësimor të përcaktuar. Ne duhet të bëjmë gjithçka që është në dorën tonë që të gjithë nxënësit dhe studentët të marrin atë që i takon, e drejta e tyre për t'u arsimuar, program të plotë mësimor. Ne nuk jemi në një gjendje të jashtëzakonshme, luftë e katastrofë natyrore, që të

pranojmë shkurtime të tilla. E thërras SBASHK-un të reflektojë, se dinjiteti i tyre brenda organizimeve nuk mund as nuk duhet të quhet interes më madhor se sa arsimit i shkollarëve tanë.

Si ministër i Arsimit mbes me shpresë se ju, deputetë të nderuar, do të prodhoni një vendim në këtë Kuvend për t'u dhënë të drejtë, mundësi atyre të cilëve shkelën të drejtat pa fajin e tyre nxënësve dhe studentëve. Para, neve në këtë Kuvend, para punëtorëve të arsimit sot shtrohet një detyrë dhe ajo është: t'u japim shkollarëve atë që u takon, programin e plotë arsimor. Ai që nuk është në dijeni të peshës të kësaj detyre, nuk është i denjë të mbulojë përfaqësimin publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së është paraqitur zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Dhe, ju qytetarë të respektuar,

Sot jemi duke debatuar për një temë, e cila nuk do të duhej të ishte temë diskutimi sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse kjo temë është dashur të diskutohet në mes të ministrisë dhe SBASHK-ut dhe të vijë deri te një zgjidhje përfundimtare.

Humbja e orëve mësimore për nxënësit ka pasoja të mëdha dhe të gjithë këtu ne jemi të vetëdijshëm se sa janë dëmtuar nxënësit dhe humbja e orëve ka shkaktuar probleme jashtëzakonisht të mëdha në procesin arsimor. Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës konsiderojmë të papërgjegjshëm ministrinë, se si nuk reagonte me kohë, se greva e Sindikatës dhe e SBASHK-ut ka qenë e arsyeshme, sepse është më se e domosdoshme rritja e koeficientit të mësimdhënësve. Të gjithë e dimë se sa i vështirë është kompensimi i orëve për vetë nxënësit, për prindërit, mësimdhënësit dhe për stafin e përgjithshëm të shkollave, prandaj reagimi i të gjithëve për kompensim të orëve mësimore është më se i kuptueshëm dhe i drejtë, pasi që kompensimi ua merr pushimet, kohën e çmueshme të fëmijëve me familjet e tyre. LDK dënon fjalorin e ngutshëm dhe qortues të MASHT-it ndaj mësimdhënësve, jemi dëshmitarë se si qëllimi i Qeverisë është që faji për gjithçka t'u adresohet mësimdhënësve, e jo politikave të gabueshme të MASHT-it. Kur faji dhe akuzat drejtohen kah mësimdhënësit, është një tendencë që kërkesat e tyre të zbehen dhe politikat e ministrisë të jenë të arsyeshme.

Prandaj, LDK është në anën e mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe është kundër që Qeveria t'i obligojë mësimdhënësit apo SBASHK-un që të kompensojë orët e humbura. Kërkesa e SBASHK-ut ka qenë jashtëzakonisht e arsyeshme për rritjen e koeficientit, kur Qeveria, ministritë kanë pasur të paguhen 80 zëvendësministra e sa këshilltarët e sa ministri, të rritin pagën për veten dhe si të mos gjenden mjete për rritjen e pagave apo të koeficientit të

mësimdhënësve, kërkesa e të cilëve ka qenë jashtëzakonisht legjitime. LDK për greva e bën të përgjegjshme ministrinë dhe jemi jashtëzakonisht të zhgënjyer si LDK pse nuk arritën ata para se të hyjnë fëmijët në greva, të bëjnë zgjidhje dhe të mos lejohet që fëmijët tanë të humbin një muaj mësim. Këtu po flitet për orët e humbura se si do të kompensohen, a nuk po flitet absolutisht se kush do të japë llogari për orët e humbura mësimore për fëmijët tanë.

LDK konsideron se edhe sikur të bëhet kompensimi i orëve mësimore, orët e humbura, të cilat duhet, sipas ministrisë që të kompensohen, nuk e kanë efektin e njëjtë dhe nuk do të ketë mësim efikas, sepse përvojat tregojnë se sa herë që ka pasur zëvendësime të orëve, nuk janë mbajtur orët e duhura sikur në përgjithësi në mësimin e rregullt.

Të nderuar deputetë dhe ju deputete,

I nderuar ministër, prindër dhe mësimdhënës, të cilët po na ndjekin, LDK mirëkupton reagimin e SBASHK-ut, të mësimdhënësve dhe prindërve dhe i bën thirrje ministrit të Arsimit që të ulen gjakrat dhe të diskutojnë bashkërisht dhe të vijnë deri te zgjidhja përfundimtare. Zgjidhja përfundimtare është që ministria dhe Qeveria të pranojnë fajin, sepse llogari duhet dhënë ju si ministër dhe si Qeveri për humbjen e orëve mësimore dhe meqë kemi ardhur në këtë situatë dhe e keni lidhur këtë farë problemi nyje, ju lus që të dy palët të uleni bashkërisht dhe të bëni një zgjidhje në të mirë të nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Seanca e thirrur sot për situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura, përkatësisht së paku 15 njësi mësimore gjatë grevës trejavore, nga 14 janari deri më 1 shkurt 2019, konsiderojmë se rezulton me mospërputhje të plan-programit mësimor, po ashtu edhe dëmet që po i shkaktohen procesit të përgjithshëm edukativo-arsimor, por qëllimi i këtij debati që ne sot jemi mbledhur nuk është për ndikuar në organet e gjyqësorit dhe organet e përgjithshme të drejtësisë, por për t'u sensibilizuar me opinionin dhe për të dhënë një qartësim të pozicioneve të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut. Dhe, vëmendja jonë sot mbetet jo vetëm për t'i dëgjuar se çka ka thënë njëra palë e çka ka thënë pala tjetër, përkatësisht Ministria e Arsimit dhe SBASHK-u. Por, është shumë e rëndësishme që në këtë kohë të tërë vullneti dhe qasja pragmatike jona të jetë e koncentruar dhe e orientuar në të mirën e ardhmërisë tonë, siç janë fëmijët në këtë rast.

Nga janari i këtij vit është krijuar një kaos i vërtetë për nxënësit, për mësimdhënësit, për prindërit dhe për gjithë sistemin e arsimit në tërësi. E kjo çështje po përcillet ende me mosmarrëveshje mes Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Vendimi i ministrit, zotit Bytyqi, për kompensim të orëve mësimore ka hyrë në fuqi në fillim të këtij muaji, por si i tillë nuk është respektuar dhe nuk është zbatuar nga shumica e shkollave fillore dhe të mesme. Ky vendim i marrë për kompensim të orëve të humbura në interesin e nxënësve për të kompensuar dëmin që iu është shkaktuar atyre nga greva, konsiderojmë se është i drejtë, por jo vendimi të jetë i njëanshëm dhe gjithashtu, konsiderojmë që paraprakisht është dashur të ketë një bashkëpunim të ngushtë mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit që të merret një vendim i drejtë në interes të procesit edukativo-arsimor dhe si i tillë të vlejë njëjtë për të gjitha shkollat në vend, të mos ketë dallime nga komuna në komunë apo nga shkolla në shkollë, sipas ndikimeve apo presioneve politike që janë bërë, sepse gjithashtu jemi dëshmitarë ku në disa shkolla dhe në disa komuna është mbajtur mësim.

Po ashtu, SBASHK-u duhet të jetë racional dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit që të gjejnë një rrugë të përbashkët dhe të drejtë me një konsensus për të mirën e nxënësve, duke pasur parasysh edhe kërkesat e Këshillit të Prindërve që plan-programi duhet të realizohet në tërësi dhe të mos dëmtohen rezultatet e testeve pasuese që vijnë, siç është ai i arritshmërisë dhe testet e tjera. Hapat që duhet të ndërmerren për të siguruar një proces të vazhdueshëm për arsim cilësor nuk duhet të ndikohen nga vendimet vetjake, por nga politikat e planifikuara mirëfilli dhe kontinuele të sistemit të arsimit. Gjendja e arsimit në vend nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe aktualisht është duke u ballafaquar me një varg problematikash, këtë e kemi të ditur edhe nga rezultatet e PISA-s. Këto probleme që janë shpërfaqur në testin e PISA-s duhet të merren shumë seriozisht dhe të mos kalojnë në heshtje, por të ndërmerren masat e duhura me veprimet konkrete. Strategjia e re e arsimit për periudhën 2017-2021 duhet të zbatohet, pra nuk është e mjaftueshme vetëm si dokument i planifikuar dhe i aprovuar, por vënia e saj në jetë duhet të jetë prioritet imediat, sepse në këtë strategji adresohen në masë të madhe çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e arritjes së cilësisë në arsim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës beson se kompensimi i orëve të humbura duhet të bëhet për të mirën e nxënësve dhe për pritshmëritë e prekshme pozitive të rezultateve në testet pasuese. Me rezolutën të cilën do ta bëjmë bashkërisht, de do të japim kontributin tonë në harmonizimin e rekomandimeve që të tejkalohet ky konfuzion i panevojshëm, i krijuar tash e sa kohë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet realizimin e plotë të planprogrameve të parapara për vitin shkollor 2018-2019, i cili do të përcillet në të gjitha matjet periodike të cilat i kemi në sistemin tonë arsimor. Mbi të gjitha dhe pavarësisht të gjitha rrethanave të cilat janë

krijuar, ne nuk guxojmë asnjëherë të harrojmë se rininë e kemi resursin kryesor që do të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Prandaj, ne Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kërkojmë që të respektohet Strategjia shtetërore, që arsimit cilësor i gjeneratave të reja të jetë prioritet. Konsiderojmë se është moment përgjegjësie dhe vëmendje e veçantë e maksimale që ne kemi për shtyllën kryesore të shtetit tonë, ardhmërinë e vendit tonë. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, z. Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ju kolegë deputetë dhe qytetarët e Kosovës,

Se në arsim ka vërtet shumë probleme, këtë pajtohemi të gjithë. Për shkak të problemeve të mëdha në arsim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje që nga 13 shkurti, e ka depozituar një kërkesë në Kryesinë e Kuvendit që të thirret një debat parlamentar për këto çështje, por neglizhenca që po ndodh në Kryesi, ka bërë që edhe pas gjashtë javësh një seancë e tillë të mos thirret.

Tash do të flas pak në mënyrë kronologjike për çështjen e grevës dhe pastaj kompensimit. Tri ditë para se të fillojë greva e paralajmëruar nga Sindikata e Arsimit, unë iu pata drejtuar me një letër ministrit të Arsimit dhe kryetarit të Sindikatës së Arsimit, me kërkesën që meqë atë ditë ishte e premtë dhe greva duhej të fillonte të hënën, që ta sakrifikojnë vikendin, të merren vesh, në mënyrë që të mos hyhet në grevë, sepse ata kishin paralajmëruar takimin pasi të fillojë greva, pra ditën e parë të grevës. Meqë ata nuk u takuan gjatë vikendit, në ditën e dytë të grevës, pra ditën e martë, ne si Komision i kemi bërë bashkë Ministrinë e Arsimit në të cilin ka qenë vetë ministri, Sindikatën, në të cilën ka qenë kryetari i Sindikatës, dhe kemi kërkuar që të merren vesh në lidhje me kërkesën e drejtë të Sindikatës së Arsimit për ngritjen e koeficientit për të ardhurat personale.

Kjo është përkrahur edhe nga Komisioni, siç është përkrahur edhe nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Pastaj meqë kjo çështje, kaluan tre javë, edhe pse në fillim ua patëm tërhequr vërejtjen se marrëveshja do të ndodhë dhe për vonesën do të kërkojmë përgjegjësi nga ata të cilët s'e kanë arritur marrëveshjen me kohë dhe tani kërkojnë përgjegjësi, nga Ministria, nga Qeveria, po edhe mendoj që Sindikata është dashur edhe pak më shumë të bëjë përpjekje që të mos shkojnë tri javë me grevë. Greva ka përfunduar dhe pastaj ka lindur problemi i kompensimit të orëve të mësimi.

Ne prapë si Komision, i kemi ftuar në një takim edhe Sindikatën, edhe ministrin, t'i harmonizojnë qëndrimet dhe të merren vesh në lidhje me kompensimin e mësimit. Mirëpo takimi në vend se t'i përfaqësojë qëndrimet, ato vetëm sa kanë qenë të larguara. Në ndërkohë, pas dy-tri ditësh, unë personalisht kam shkuar në kryesinë e Sindikatës, dhe i kam lutur që vërtet ta kenë parasysh peshën e vendimit sepse po merret vendim për çështjen e nxënësve, 400 mijë shkollarëve, të cilët po humbin.

Bazuar në atë që është dëgjuar nga ministri, edhe sidomos nga Sindikata, del se këtu ka të bëjë më shumë me inate në mes të ministrit dhe Sindikatës sesa që është diskutuar problemi esencial e ajo janë nxënësit. Sindikata edhe në takimin që e kishim pat kushtëzuar mbajtjen e mësimit me tërheqjen e vendimit të Ministrisë, që nuk ka qenë absolutisht ndonjë kërkesë shumë e rëndësishme sa i përket mësimit. Kurse Ministria si duket ishte e prekur nga rasti se Sindikata në vend se të bëjë marrëveshje me ministrin, kishte bërë marrëveshje me kryetarin e Kuvendit që është krejt e palogjikshme. Nuk ka qenë çështje e kryetarit të Kuvendit, por ka qenë çështje e Ministrisë dhe e Qeverisë.

Por, ajo që është me rëndësi, në fund të fundit, viktimë e këtyre mosmarrëveshjeve dhe inateve janë mbi 400 mijë shkollarë të Republikës së Kosovës, prandaj unë këtu në emër të Lëvizjes Vetëvendosje kërkoj nga të palët që t'i përfaqësojnë qëndrimet, që Sindikata kur të vendosë për këtë çështje t'i kenë parasysh nxënësit dhe interesat e tyre dhe jo ministrin dhe Ministrinë, as Komisionin, as Kuvendin, po do të duhej të koncentrohej me logjikën e mësuesit, që të mos lejojnë që të viktimizohen nxënësit, të cilët deshëm apo s'deshëm ta pranojmë, nëse i humbin tri javë dhe nuk kompensohet mësimi, ata do të humbin shumë gjatë këtij viti shkollor, prandaj po e përfundoj me apelin që të arrihet një marrëveshje në dobi të shkollarëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka znj. Haxhiu në emër të AAK-së. Po, e kanë renditur gabimisht këtu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju kolege,

Çështja për të cilën jemi mbledhur në një seancë të jashtëzakonshme është shumë e rëndësishme, por për mua sinqerisht edhe një pikëpyetje e madhe se kush është punëdhënësi. Kush është punëdhënësi pra në këtë rast. Atë që e elaboroi kryetari i Kuvendit dhe këtë që e tha së fundmi kryetari i Komisionit, unë po ndalem pak këtu.

Komisioni parlamentar përbëhet nga të gjitha subjektet politike. Përpjekja e vazhdueshme e Komisionit pra që nga fillimi, para se të ndodhë greva, e deri në ditën e sotme ka qenë njëqind për qind në gjetjen e zgjidhjes, qoftë para se të mbahet greva, por njëkohësisht edhe për zëvendësimin e orëve të humbura. Unë çka nuk kuptoj, atë që jemi bashkë dhe e themi në

komisione, dhe atë që në realitet ndodh ndonjëherë të thuhet krejt diçka tjetër. Pra edhe një herë, pas mbajtjes së grevës, jemi mbledhur si Komision, kemi shkuar në Ministrinë e Arsimit, ku ministri, pra anëtarëve të Komisionit, unë konsideroj që kemi qenë të gjitha subjektet politike, na e ka treguar vendimin që Ministria pra ka marrë vendim për kompensimin e orëve të humbura.

Pra, ka qenë komisioni parlamentar në Ministrinë e Arsimit, në zyrën e ministrit dhe ministri na ka treguar pra edhe se si do të ndodhë kompensimi i orëve. Dhe ne si Komision, është mirë të deklarohe mi këtu, jemi dakorduar që të gjithë që pajtohemi me vendimin që ka marrë Ministria për kompensimin e orëve. Unë të paktën nuk them për diçka që kam qenë pjesë e takimit, dhe është mirë pra secili subjekt të tregojë a janë pajtuar. Pra kjo ka ndodhur në Ministrinë e Arsimit, që nënkupton me vendimin e Ministrisë, që nënkupton tutje jemi kthyer në Komision, megjithatë nuk ka ndodhur që të për afrohen mendimet e SBASHK-ut dhe të Ministrisë. Prapë jemi takuar si Komision dhe i kemi ftuar edhe një herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. pra si Komision, edhe SBASHK-un, edhe Ministrinë.

Ajo që për mua është shqetësuese që e tha, vërtet pajtohem me kryetarin e Komisionit, t'i lëmë inatet personale. Ne kemi shkuar dhe e kemi vizituar një shkollë në fakt në Drejtorinë e Arsimit në Fushë Kosovë dhe problemin e nxënësve nëpër paralele, problemin e nxënësve të cilët në Komunën e Fushë Kosovës nuk kanë paralele parashkollore, ky është problem i nderuar deputet. Dhe tash llogaritni, dyzetepesë nxënës në një paralele, një mësimdhënës po qe se njëqind për qind është i përpiktë dhe shkon në klasë, tamam dyzet minuta apo dyzetepesë që fatkeqësisht nuk mbahen orët dyzetepesë minuta, i bie nëse është i përpiktë njëqind për qind, që për secilin nxënës ta ketë më pak se një minutë, derisa ta shkruan orën, derisa ta shtjellon njësini mësimore, humb edhe ai një minutë. Tani pesëmbëdhjetë ditë, vetëm pesëmbëdhjetë ditë nga një minutë, vetëm për dyzet nxënës nëse është ora dyzet minuta, pra janë dyqind minuta më pak të nxënësve të klasës së parë. Për dyqind minuta më pak një nxënës i klasës së parë, unë nuk e di sa mund të arrijë të nxë, pa vazhduar tutje, deri në klasën e nëntë, apo edhe shkollimin e mesëm.

Pra, Komisioni ka qenë i gatshëm, është i gatshëm të gjejë zgjidhje. Ka bërë përpjekjet maksimale çdoherë, por unë nuk kuptoj pse qëndrimet nuk janë të njëjta sikurse janë në Komision? Pra, në Komision që të gjithë njëzëri kemi qenë të gjejmë zgjidhje.

Për mua është zgjidhja më e mirë, jo pse Ministria ka qenë shumë e përpiktë në këtë rast, por zgjidhja më e mirë ka qenë pra mbajtja e orëve sipas vendimit të Ministrisë. Pse? Nëse ne tentojmë t'i mbajmë orët pas përfundimit të vitit shkollor, si një ish-mësimdhënëse për 27 vjet për mua është shumë e pakuptimtë. Nuk jemi ne Gjermani, nuk jemi Zvicër, nuk kemi kushte për të mbajtur mësim të temperaturat që janë deri dyzet gradë. Nuk kemi ne kushte. Pra, paralelet tona nuk kanë as perde klasat tona, e le më të kenë klimë.

Unë nuk e di sesa mund të mbahen orët. Atë që unë e di, mësimdhënësit janë të gatshëm, vërtet janë të gatshëm, por janë në lajthitje. Sot flitet për t'u mbajtur orët, del SBASHK-u të mos mbahen orët. Ajo që mua më ka shqetësuar në takimin e Komisionit, kryetari i SBASHK-ut, po e citoj, ka thënë: Më mirë është të humbë një vit, sesa vitet e tjera. Për mua një vit është një gjeneratë. Për mua kjo është e pakuptueshme. Nëse flasim për nxënësit që janë humbësit më të mëdhenj këtu, mos harroni po flasim për nxënësit jo të politikanëve, sepse i kanë fëmijët në shkollat privat, po flasim për ata nxënës të cilët janë pra të prindërve, të cilët shumica e tyre nuk i kanë kushtet tona. Pra unë nuk mund të them diçka që nuk e kam thënë në Komision, nuk mund të veproj ndryshe sot në këtë seancë. Dakordimi i plotë i Komisionit ka qenë të mbahen orët sipas vendimit të Ministrisë, por njëkohësisht unë kërkoj që Ministria pra të gjejë zgjidhjen që nënkupton, për mua, ajo që është edhe më shqetësuese, pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative refuzohet si e pabazuar kërkesa e padisë pra e SBASHKU-ut.

Për mua tani, nëse presim në një vendim tutje, e dimë gjykatat se kur marrin vendime. Pra, ajo që ne po synojmë çdo ditë, ndoshta pa bërë politikë, por sinjerisht me një përkushtim shumë të madh, që të ndihmojmë që politikën ta largojmë nga arsimit, unë konsideroj që jemi duke e politizuar shkajshmërisht. Arsimit nuk është i një subjekti politik. Arsimit nuk është as i Aleancës, as i PDK-së, as i LDK-së, as i Vetëvendosjes, po as i Nismës. Pra, krejt nxënësit janë të Kosovës, por edhe mësimdhënësit e ciklit klasor nga klasa e parë deri në klasën e pestë të cilët padrejtësisht janë diskriminuar në koeficientin për pagat. Kjo për mua ka qenë e pakuptueshme që nuk ka qenë e zëshme, as Sindikata në këtë rast.

Ajo që hala më shumë e fuqizon këtë, Këshilli i Prindërve është deklaruar për mbajtjen e mësimin. Pra, e ka përhëndetur një vendim, unë e kam deklarimin edhe të kryetarit të Këshillit të Prindërve të Kosovës.

Por, njëkohësisht në komision prapë e kemi pasur edhe Këshillin e Mësimdhënësve të paraleleve 1-5, dhe unë personalisht ju kam bërë pyetje; a jeni për t'u mbajtur orët mësimore? Që të gjithë janë deklaruar, është procesverbali, e kemi transkriptin në komision, janë deklaruar që jemi për t'u mbajtur orët mësimore.

A duhet që ne të bëjmë politikë? Unë konsideroj që këtu vërtet po bëhet politikë. Pra, zgjidhja është; nëse mësimdhënësit i kanë zëvendësuar orët në kohën kur kanë pasur kushte shumë të vështira, dhe asnjëherë nuk e kanë shikuar interesin e vet, ata i kanë mbajtur orët sa herë që kemi pasur probleme për shtyrjen e gjysmë vjetorit të dytë për shkak të kushteve atmosferike. Për shkak të kushteve jo të mira nëpër shkollat tona. Për shkak jo të mira në paralelet tona.

Pra, ne sot duhet të diskutojmë për kushtet që duhet t'u bëjmë më të mira mësimdhënësve, nxënësve, e jo t'i qesim në lajthitje.

Unë konsideroj që secili mësues është dhe që jam shumë e sigurt që ata janë të përkushtuar 100% që të mbajnë mësim, por kjo lajthitje, mbajtja e mësimit ose jo, vërtetë po e zbeh punën e tyre pa qëllim, në kuptimin se ata nuk janë të gatshëm ta humbin asnjë orë.

Por, derisa nuk jemi seriozë që interesat e tyre në kohën e duhur, pra të merren parasysh. Të vlerësohen për punën që e bëjnë çdo ditë e që nuk ndalën, e që kemi shumë mësues të mirë, por në këtë rast po flasim për diçka që komisioni e ka kryer punën e vet. Ne mund të takohemi sa herë të duam, por në fakt kjo që u tha në fillim që komisioni të mblidhet prapë, unë nuk në e shoh si zgjidhje.

Pra, tendenca që të mblidhet komisioni edhe njëherë, unë nuk e shoh si zgjidhje. Ministria ka marrë një vendim. Gjykata Themelore e ka pezulluar një kërkesë të SBASHK-ut...

KRYESUESI: Faleminderit! Nga PSD-ja? Kush dëshiron ta marrë fjalën në emër të PSD-së? Zoti Çausi, urdhëroni!

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Është mirë që po pajtohemi të gjithë në një pikë. Me gjithë ato që u thanë që për shkak të dështimit të palëve përgjegjëse, është organizuar është thirrur kjo seancë, mirëpo do duhej të dekoroheshim që nëse pajtohemi që viktimat e kësaj greve dhe kësaj humbjeje që ka ndodhur, janë fëmijët, nxënësit, atëherë edhe do duhej të përmbaheshim brenda kësaj çështjeje që po e diskutojmë.

Pra, mendoj se duhet ta themi të vërtetën edhe të mos shmangemi duke kontribuar në polarizimin edhe më të madh të dy palëve që tashmë janë barrikaduar. Po, këtu qartë ka një qëndrim të ngurtë dhe joparimor nga SBASHK-u, ku të paktën ne si komision, por besoj që të gjithë deputetët tashmë e kanë të qartë.

Pra, mund të konstatojmë që gjendja në arsim është shumë e rëndë. Mund të konstatojmë që ka probleme. Ka punësime partiake. Mund t'i bëjmë të gjitha diskutimet e mundshme në lidhje me ministrinë, vetëm se nuk kontribuojmë për atë që jemi mbledhur.

Pajtohem me propozuesin që duhet të bëjmë një dallim shumë të qartë mes kësaj greve dhe pasojave të saj, dhe cilës do grevë të ndonjë sektori tjetër. Pra, nuk po flasim për ndërmarrje ku nga mospuna, nga greva pëson pronari i saj i çfarëdo natyre, por po flasim për një të drejtë të cilën si parti socialdemokrate e mbrojmë dhe e respektojmë, por ku pasojat janë shumë të gjëra. Janë shoqërore dhe viktimat janë nxënësit.

Kryetari i Komisionit për Arsim, zoti Ismajl Kurteshi e bëri një përshkrim të përpjekjeve tona dhe të asaj që ka ndodhur. Më duhet kujtoj prapë që qëndrimet e SBASHK-ut nga fillimi i grevës, edhe këtë duhet ta pranojmë të gjithë kanë qenë aspak parimore.

Pra, është thënë nuk kompensohen orët. Ka pasur disa deklarime të nënkryetares së SBASHK-ut e cila ka premtuar kompensimin e orëve. Pas përfundimit të grevës, kemi diskutuar në komision. Kam propozuar që t'i ftojme të dyja palët edhe të ndërmjetësojmë në njëfarë forme për të gjetur një zgjidhje.

E kemi mbajtur me datën 15 mars një takim të tillë dhe për mua ka qenë shumë shqetësuese...Të shtoj këtu që pajtohem zonjën Haxhiu, kemi qenë në ministri dhe na është prezantuar plani dhe kemi qenë si komision, pra të gjithë anëtarët kemi që të pajtimit me planin që është prezantuar.

Në ballafaqimin e dyja palëve, të SBASHK-ut dhe ministrit, për mua ka qenë shumë shqetësues një fakt, po e përmendi vetëm një, në qëndrimin e kryetarit të Sindikatave të Bashkuara të Arsimit. Pra, e kam pyetur se cili është problemi ose kundërshtimi përmbajtjesor në lidhje me planin e prezantuar nga ministri, dhe ai ka thënë që nuk ka asnjë problem, vetëm se vendimi duhet tërhequr.

Po them prapë, ne mund të shmangemi, mund të flasim për problemet në arsim, mirëpo në një gjë pajtohemi që ministri e ka në pjesë të përshkrimit të punës së tij të mbështetur edhe nga një udhëzim administrativ, mbarëvajtjen e mësimi.

Megjithatë, ne kemi propozuar që t'i jepet edhe një javë, konkretisht kryetari i komisionit, zoti Kurteshi, për ta gjetur një zgjidhje.

Ajo që unë kam parë gjatë kësaj kohe ka qenë, po them një kundërshtim absolutisht jo racional për mendimin tim, nga krerët e SBASHK-ut dhe asnjë përpjekje për ta gjetur një zgjidhje për kompensimin e mësimi.

Tani, të flasim këtu se cili është dëmi, besoj që çdo qytetar e ka të qartë se kur flasim për 160 deri 185 ditë mësim dhe nga këto 14 mungojnë e kemi të gjithë të qartë se për çfarë humbje po flasim.

Qëndrimi i vazhdueshëm i përsëritur disa herë i kryetarit të SBASHK-ut, që ky vit le të dëmtohet, ky vit le të humbë, por t'i bëjmë të tjerët si duhet... Për mua është shqetësues dhe në të njëjtën kohë është shqetësuese që ky është zëri që përfaqëson punëtorët e arsimit në Kosovë.

Pa asnjë arsye tjetër personale vetëm se të mbash kësi lloj qëndrimesh, duke pasur parasysh seriozitetin e gjithë kësaj humbjeje, për mua është shumë shqetësuese.

Nuk mund të jesh edhe me nxënësit edhe të refuzosh kompensimin. Dëgjova më herët nga përfaqësuesja e Lidhjes Demokratike të Kosovës e cila mbante një qëndrim të tillë.

Si komision, besoj që e kemi bërë përpjekjen tonë. Unë mendoj që duhet një shenjë, një vullnet nga ana e SBASHK-ut, për t'u përafuar dhe për ta rihapur këtë diskutim. Nëse ky plan i prezantuar nuk është më i miri i mundshëm, unë nuk besoj që kjo është esenca e problemit.

Për mua ka qenë çështje inatesh. Kur thua të tërhiqet vendimi, por me planin nuk kam problem, kjo nuk tregon asgjë përmbajtjesore ose racionale për mendimin tim.

Pra, ne e mbështesim kërkesën e kësaj rezolute. Ajo që mund të bëjmë, është prapë të bëjmë një ftesë për SBASHK-un, edhe po e përsëris prapë të jemi parimor në ato që i themi. Të gjithë jemi të informuar për qëndrimet që janë mbajtur. Të gjithë e kemi të qartë që është çështje inatesh, dhe shpresoj të paktën që kjo seancë në mos asgjë tjetër, të kontribuojë që të sjellë, të krijojë një hapësirë dhe një emergjencë për ta trajtuar këtë çështje nga ana e SBASHK-ut, duke shpresuar edhe duke besuar nga ajo që kemi parë deri tani, që ministria ka qenë dhe vazhdon të jetë e gatshme për një marrëveshje. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Nisma Socialdemokrate, zonja Albulena!

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Ministra,

Ndoshta fjala ime do të ishte pak më e gjatë, por pas fjalës së kryetarit të Kuvendit, mendoj që secila fjalë tjetër ndoshta është e tepërt, për shkak se kryetari i Kuvendit tashmë tha se Sindikata është gati ose është e gatshme t'i përputhë mendimet e veta me ministrinë dhe me neve si deputetë që po kërkojmë kompensimin e orëve të humbura.

E thanë edhe kolegët deputetë që ne si Komision i Arsimit jemi takuar me Sindikatën, po ashtu shpesh edhe me ministrinë e Arsimit, dhe kemi diskutuar për këtë. Por, asnjëherë deri më tani Sindikata nuk ka pranuar që të bashkëpunojë me ne, po as me ministrinë e Arsimit dhe këto orë të kompensohen. Nuk e di pse, është hera e dytë që Sindikata po gjen gatishmëri që të bashkëpunojë me kryetarin e Kuvendit.

Ne në fakt e kemi lutur, si Komision i Arsimit, të vijmë në një mendim të përbashkët edhe me ministrinë, por që deri më sot, në këtë moment të paktën, nuk kemi marrë një gatishmëri të tillë.

Edhe ju zoti ministër, zoti Bytyqi, kur LDK thotë se, ne jemi edhe me nxënësit edhe me Sindikatën edhe me mësimdhënësit, po veç me ministrinë jo, është dashur të ngitesh zoti ministër e të thuash se nuk mund të jenë edhe me nxënësit, edhe me Sindikatën, edhe me mësimdhënësit.

Pra, duhet të jeni ose me nxënësit dhe me ministrinë, pra t'i zëvendësojmë këto orë që të mos humbin nxënësit ose me Sindikatë, e cila është kundër zëvendësimit të këtyre orëve, ose të jemi me mësimdhënësit të cilët janë një pozicion tepër të keq, të pa lakmueshëm sepse as vet nuk e dinë se kë ta mbështesin.

Unë po e lexoj, po e citoj pikën e parë (1) të çdo kontrate të secilit mësimdhënës, e cila thotë kështu:

1. Të realizojë planprogramin mësimor përkatës të punës, duke u bazuar në Ligjin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante në vendin e tij/saj të punës.

Pra, ata e kanë për obligim që në bazë të kontratës së nënshkruar nga ta të arrijnë që ta realizojnë planprogramin e tyre mësimor. Dhe nëse humbin këto 15 ditë, jam e sigurt që asnjë mësimdhënës nuk mund ta arrijë planprogramin mësimor gjatë këtij viti.

Fjalën time desha ta lidh me tri vendime, vendime krejt të ndryshme; është vendimi i cili po pritët prej gjykatës, është vendimi i ministrit dhe vendimi i SBASHK-ut. Pra të tirja këto vendime të kundërta, ne po presim dhe po bëjmë thirrje, pa dashur të ndërhyjmë në organet kompetente të së drejtës, pra po bëjmë thirrje që ky vendim të dalë sa më shpejtë dhe të shohim se kush në fakt ka pasur ose ka të drejtë për zëvendësimin e këtyre orëve.

Ndërsa vendimi i ministrit, po e cek prapë, nuk ka qenë i vetëm. Ne si komision e kemi mbështetur ministrin e Arsimit për të marrë një vendim të tillë për zëvendësimin e orëve. Bile ne si komision, nëse ju kujtohet, kur kemi shkuar në ministri, i kemi ministrit që këtë vendim ta nxjerrë sa më parë, por që ministri me arsyetimin që shkollat të mos shpenzojnë më shumë, ka dashur që në një kohë më të përshtatshme të mbahen këto orë të humbura.

Vendimi i ministrit është dashur të diskutohet si nga SBASHK-u, si nga mësimdhënësit, nuk e ka bërë, nuk ka diskutuar ose hapur debat nga asnjë palë, por ky vendim ka ardhur si rezultat i asaj që nxënësit do të duhej të përfitonin atë që kanë humbur me ato orë të cilat nuk janë realizuar.

Pra, unë i bëj thirrje edhe tash SBASHK-ut, meqë një vendim nga gjykata tashmë ka dalë për mospezullimin e vendimit të ministrit, ata të vazhdojnë t'i kompensojnë këto orë, e pastaj pas seancës, siç edhe kryetari i Kuvendit tha, ne si komision jemi në gjendje të takohemi prapë e të diskutojmë, por që gjithmonë me “kushtin” që këto orë të zëvendësohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit 6+, zonja Mufera Shinik.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Saygılar, 14 Ocak 1 Şubat tarihlerinde eğitim sendikasının kararıyla maaşlardaki düzenleme vesilesiyle yapılan grevin telafisini tartışıyoruz. Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığı ve Eğitim Sendikası temsilcileriyle Meclis Eğitim Komisyonunda konuyu enine boyuna tartıştık. Bu sürecin artık hem bakanlıktan hem de sendikadan çıktığı bilinmektedir. Mahkeme kararını beklediğimiz bu süreçte bu oturumun yapılması ne kadar uygun olacağı tartışılır. Başka herhangi bir konuyla ilgili siyaset yapabiliriz, ancak öğrenciler, öğretmenler ve eğitim üzerine yapılan siyaseti uygun görmüyoruz. Ancak soru sorulması gerekiyorsa sendikaya sormak gerek. Bu kadar görüşmeden sonra 1-5 sınıf öğretmenlerinin, branş öğretmenlerinin katsayısından daha düşük olmasını neden kabul ettiniz?

Bu durumda Kosova Eğitim Bakanlığı ve Eğitim Sendikasının anlaşması sonucu Sendikanın konuyu mahkemeye vermesiyle, Mahkeme sonuçlarını beklemek gerek. Sendika telafi edilmeyecek, Bakanlık telafi edilmeli derken, mahkeme bu konuya ne diyecek? Okullar fabrika değil, ayakkabı üretmiyor, elbise üretmüyor, derslerin telafisi gerekir, çünkü derslerin kaybolması, müfradatın gerçekleşmemesi demek. Bir sınıfın 100'ün üzerinde derslerini kaybetmesi, gerçekten üzücü bir durum. Ancak mahkeme süreci bitmeden, bu tartışmanın gereksiz ve verimsiz olacağını düşünüyoruz. Öyle ki Eğitim Bakanlığı ve Sendikanın derselerin telafinin tarihini belirlerken, bazı okullarda başladığı gibi, Cumartesi gününü çalışılacaksa, 5 Mayıs - 5 Haziran arası Ramazan ayında olmaması için özellikle dikkat etmelerini öneriyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër e ka kërkuar fjalën. Zoti ministër, urdhëro!

Ide e mirë do të ishte të shkohet drejt zgjidhjes së çështjes, ose debatit, i cili nuk zgjidh asgjë, sa për konsum, të fitohen pak vota.

MINISTRI SHYQIRI BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit deputete Balaj!

Në fakt, ne nuk reaguam në kohë kur deputetja e LDK-së kishte fjalimin e saj, për arsye se pritëm derisa të përfundojnë të gjitha diskutimet e grupeve parlamentare.

Unë konsideroj që çdo temë në Parlament nganjëherë mund të jetë edhe çështje politike dhe mund të kalojë në fushatë elektorale, por kisha kërkuar që jo për çështje të arsimit dhe jo të thuhet gjëra të cila nuk qëndrojnë.

Ne si ministri dhe unë si ministër jam shumë i kujdesshëm që asnjëherë të mos e lëndoj askënd, e veçanërisht mësimdhënësit.

Në asnjë deklaratë timen publike nuk kam bërë ndonjëherë ndonjë sulm ndaj mësimdhënësit, përkundrazi, konsideroj që jam zëri më real në mbrojtjen e të drejtave të mësimdhënësve, për të cilin jemi deklaruar edhe gjatë kohës kur ka qenë edhe greva.

Vetëm një sqarim publik duhet ta bëjmë.

Ministria e Arsimit dhe unë si ministër e kam marrë një vendim për kompensimin e orëve bazuar në obligimet që jep Ligji i Ministrisë së Arsimit, është bërë në dakordim të plotë me DKA-të, ku janë të përfshira, konsideroj, të gjitha partitë politike, si kryetarë të komunave si dhe drejtorë të DKA-ve dhe ky vendim nuk është marrë ndaj SBASHK-ut, vendimi është marrë ndaj sistemit arsimor, kompensimi i orëve, realizimi i plan-programeve. Në asnjë moment ministria dhe unë si ministër nuk ka pasur një synim ta sulmojë një grup të caktuar.

Reagimet që kanë ardhur të mëvonshme, që edhe për neve kanë qenë të arsyeshme, ne kemi qenë shumë të kujdesur që të mos nxisim debat, shpesh u kemi ikur edhe debateve publike, sepse për neve ka qenë e rëndësishme të bëhet kompensimi ose të minimizohet dëmi tashmë i shkaktuar pjesës më të rëndësishme të sistemit arsimor të fëmijëve tanë.

Kemi qenë dhe jemi të gatshëm çdo herë të gjejmë çfarëdo modaliteti për çdo aktor që do të përfshihet, vetëm që të mos dëmtohen nxënësit dhe fëmijët tanë, të tjerat mund të jenë deklarime politike. Ne mund të flasim këtu për shumë gjera që sistemi arsimor ka nevojë të ndryshojë, pajtohemi plotësisht me deputetin Driton që thotë që ka gjëra për të cilat duhet diskutuar dhe të rregullohen në sistemin arsimor, por që sot e kemi një temë më të rëndësishme, të dalim nga situata dhe të kompensohen orët që janë shumë të rëndësishme për këtë sistem edhe për këtë periudhë kalendarike.

Unë mendoj, në vend që të diskutonim ndoshta për një zgjidhje që të kemi orar më të zgjatur nëpër shkolla tona, fatkeqësisht po jemi të detyruar të diskutojmë a duhet të kompensohen orën apo nuk duhet të kompensohen orët.

Të keni parasysh, analizat që kanë dalë nga Banka Botërore, ku flitet për mungesën e viteve të shkollimit, janë edhe si pasojë që nëpër shkollat tona mbahet mësim tri orë e gjysmë e katër orë mesatarja. Ndërsa në vendet që bëhen krahasim, mesatarja e orëve që mbahen mësim është shtatë deri tetë orë. Pra, ndoshta tema më e rëndësishme do të ishte të flasim për këtë se sa a duhet të kompensohej. Konsideroj që a duhej të kompensohej nuk do të ishte fare në pikëpyetje, vetëm do të ishte në pikëpyetje modaliteti sa më i përshtatshëm edhe për shkolla, edhe për DKA-të për zbatimin dhe kompensimin e orëve të humbura.

Pra, ministria e ka marrë vendimin që e obligon ligji, ekzekutimin e vendimit e kanë obligim të gjitha DKA-të e secilës komunë që konsideroj që përfaqësohen këtu nga të gjithë partitë politike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë 14 deputetë që kanë kërkuar fjalën, do ta marrin secili, a dëshironi të shkoni në një konkluzion, apo të shkojmë në diskutime. Nuk jeni shumë të interesuar për zgjidhje, jeni për diskutime.

Fjalën e ka Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Ministra të nderuar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Medie,

Unë e di që është shumë e rëndësishme kjo temë, ky diskutim, por nuk e di pse duhet të diskutohet se a duhet të plotësohen orët apo jo.

Unë nuk besoj që asnjë prind në Republikën e Kosovës pajtohet me mosplotësimin e vitit shkollor, tani nuk jem në gjendje lufte, nuk jem në kohën e paraluftës, kur mësimit tanë kanë pasur vështirësitë, e që e kanë plotësuar arsimin me prindërit që kanë mundur t'ua plotësojnë sado pak një mbështetje ekonomike dhe e kanë mbajtur mësimin, nuk kanë përtuar, nuk e kanë lënë, e kanë rrezikuar veten, familjen e vet.

Prandaj, sot në liri, ku për çdo hap, çdo orë që bëhet ne e paguajmë me taksa tona dhe duhet të diskutohet se a do të plotësohet viti shkollor, mendoj që është ide e gabuar.

Tani duhet gjetur një zgjidhje si do të plotësohet, po jo a do të plotësohet, a do të plotësohet nuk ka vend. Nuk besoj që asnjë prind sot do të pajtohet që fëmija i tij të mos të jetë i plotë në përfundim të vitit shkollor.

Sigurisht që këtu ka pasur mosmarrëveshje, këto mosmarrëveshje është dashur të zgjidhen me kohë, po jo të vijë deri te diskutimi se një nxënës ka bërë vitin dhe në fund nuk është i plotësuar me mësimin në tërësi.

Prandaj, kjo nuk duhet të jetë, duhet të bëjmë zgjidhjen dhe të mos ketë paqartësi që a do të plotësohet apo jo. Ne nuk mund t'i tregojmë Evropës a botës që jemi të plotë, apo nesër të kërkojmë që një student yni të pranohet nëpër universitetet e ndryshme, po edhe mundësi të punësimit të ndryshëm, ku nuk është plotësuar shkollimi në tërësi.

Unë e di që arsimtarët tanë kanë qenë dhe kanë treguar gjithmonë veten dhe kanë dhënë kontributin e vet. Prandaj, në këtë moment nuk besoj që do të jetë diskutim pikërisht nga ata, po sigurisht që kjo punë që ata do ta bëjnë ju plotësohet edhe me pagesa.

Kërkesat e tyre ne i kemi plotësuar, më duket që i kemi aprovuar dhe i kemi votuar plotësimin e kërkesave të arsimtarëve.

Prandaj, sot nuk ka tjetër përpos se ne duhet gjetur formën si të plotësohet, jo diçka tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Valentina Bunjaku-Rexhepi, nuk qenka e pranishme. Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që kjo çështje ka ngritur shqetësim, sidomos te prindërit që kanë fëmijë nxënës të të gjitha kategorive që janë përballur me grevën e gjatë. Por mënyra e debatit mendoj detyrimisht ka involvuar edhe diskutime të tjera tash që lëshohen ndoshta edhe në rrafshin personal, edhe atë profesional, po mbi të gjitha të gjendjes së krijuar dhe dëshirës që kjo çështje të zgjidhet në mënyrë më të mirë të mundshme për fëmijët tanë.

Zoti ministër, nxënësit janë fëmijët tanë, edhe mësuesit janë po ashtu prindërit tanë, janë edhe prindër të fëmijëve dhe përfaqësuesit e tyre tash që janë sindikata. Mendoj që raporti mes tyre dhe juve është imediat, edhe si pjesë e këtij diskutimi, sepse problematika lind këtu, nuk janë problematikë e këtij procesi fëmijët e as mësuesit.

Mësimdhënësit kanë kërkuar paga të dinjitetshme që është e drejtë elementare e tyre. Shumica prej nesh i kemi mbështetur, edhe me Ligjin për pagat, por krijimi i situatës, e cila e ka lejuar që të ketë humbje orësh është detyrim dhe përgjegjësi juaja dhe e SBASHK-ut. Kjo nuk është përgjegjësi e fëmijëve as e mësimdhënësve dhe tash në këtë aspekt, ne veç jemi të lidhur drejtpërdrejt me procesin e arsimit dhe bartim edhe përgjegjësi prindërore, kemi pasur edhe takime për të dalë nga kjo situatë. Dhe, pjesë e këtyre takimeve ka disa zgjidhje, të cilat janë propozuar, qoftë e shtuna, qoftë orët e zgjatura, por fëmijët janë mësuar tash me pushime të rregullta dhe është edhe pjesë psikologjike e nxënies së një mësimi adekuat dhe të avancuar, ashtu siç dëshirojmë të gjithë ta kemi në Republikën e Kosovës.

Kështu që edhe adresimi juaj po më duket pak a shumë është i limituar, nuk dua ta quaj të gabuar në rrafshin e raportit Kuvend dhe Ministria e Arsimit, sepse ju jeni bartës të politikave arsimore, jeni edhe ekzekutiv dhe këtë raport unë e pashë edhe në atë që doli në sipërfaqe edhe në raportin me Komisionin Parlamentar.

Mbi të gjitha mënyra se si interpretojnë kolegët takimet me ministrinë, me juve, me SBASHK-un, tregon që njerëzit nuk janë të interesuar ta avancojnë procesin mësimor, më shumë janë të interesuar të kenë klientelë brenda mësimdhënësve, brenda drejtorive të ndryshme, drejtorive komunale, se sa të ketë avancim të plotë të arsimit në Republikën e Kosovës, sidomos në nivelin e ulët dhe të mesëm arsimor.

Dhe, pa dashur të mos harrojmë edhe pjesën e universitetit, i cili detyrimisht ka qenë i implikuar në këtë pjesë.

Andaj, ju sot më shumë e kuptoj që keni dashur të kërkonit një ndihmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të forcuar pozicionin tuaj karshi kësaj kërke. Po këtë pozicionin nuk mund të shndërrohem tash në palë të ndërmjetme këtu dhe të bëmë një vendim, i cili i çorienton krejt të arriturat, e zbutjes së një dallimi të madh që ka ndodhur mes jush, SBASHK-ut dhe mësimdhënësve në Republikën e Kosovës. Po më duket kjo është pak e padrejtë. Nuk e di se si e keni logjikuar ju dhe ata të cilët e kanë sponsorizuar këtë seancë plenare, por po shpresoj që ne detyrimisht, sidomos ata të cilët më me kompetencë mund të flasin për procesin arsimor në Republikën e Kosovës, duhet ta japin një zgjidhje adekuate, e cila e prish balancën tash pasi kjo çështje ka dalë në sipërfaqe.

Ne e dimë, këshillat e prindërve, ju e dini, jeni njoftuar që kanë mbajtur shumica takime dhe cili është opinionin e tyre. Kjo është provuar edhe javën e kaluar, shumica e fëmijëve tanë kanë mbetur para dyerve të shkollës nga 2,3,4 nxënës, pjesë e asaj jam përballur edhe vetë. Ndërsa as s'ka pasur personel arsimor, po as nuk ka pasur nxënës të tjerë dhe kush tash duhet ta japë këtë përgjegjësi, llogari e kujt është kjo?

Unë nuk po ju kuptoj sinqerisht as ju, në këtë raport, me ata se çka po doni dhe si po doni ta zgjidhni këtë çështje.

Kështu që, pa dashur të hyj në gjetjen apo për të kërkuar kush është fajtor në këtë mes, ajo çka është primare dhe që është një problem i tejkaluar se është zgjidhur çështja e rritjes së pagave dhe tash mbulimi dhe kërkesa për mbulimin e orëve besoj dhe shpresoj që do një analizë më adekuate.

Paramendoni, dhe ju e dini, se e dëgjove këtu që ka shumë klasë që janë me 30-40 nxënës në Republikën e Kosovës, në vende të ndryshme. Po çka nëse shumica e prindërve nuk e përfillin kërkesën që të mbahet mësimi gjatë ditëve të pushimit?

Nëse marrin pjesë, po e zëmë në një klasë 30 nxënës, 15 shkojnë, 15 nuk shkojnë, a do të kthehet ai mësues prapë për të njëjtat njësi t'i përsërisë, a do të duhej që ata fëmijë të ndëshkoheshin për shkak të tekeve tuaja, nuk po flas juve si ministër, i ministrisë, i Qeverisë, SBASHK-ut. Andaj,

këto janë çështje të cilat mendoj që do të duhej të kishin një analizë dhe një strukturim të gjendjes më adekuate se sa të bëhet debat parlamentar dhe të involvohet Kuvendi në diçka të cilën pak ka përgjegjësi në pjesën ekzekutive të një çështjeje të caktuar. Ne kemi përgjegjësi të mbikëqyrjes së politikave arsimore dhe zbatueshmërisë së ligjeve në përgjegjësi. Po nëse flasim, atëherë duhet të flasim për ligjet në tërësi, edhe për organizimin sindikal, edhe për të drejtat e tyre, po edhe për të drejtat e fëmijëve dhe të mësimitdhënësve.

Asnjë e drejtë tash nuk mund ta parashtrojmë, as nuk mund ta favorizojmë në këtë aspekt, cilës do t'i japim përparësi ne sot? Do t'i japim përparësi të drejtës së SBASHK-ut për organizim sindikal, të mësimitdhënësve, tuajën si ministri në kërkesën për zbatimin e një politike dhe të drejtave të fëmijëve për të pasur pushim meritator, ashtu siç e kanë të gjitha vendet demokratike.

Unë po mendoj që ju duhet të uleni sot me Komisionin FunkSIONAL, ta trajtoni këtë çështje pak më të përafuar dhe në përputhshmëri, për mendimin tim, me të gjitha ligjet që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Dhe, për fund, nuk është adresë këtu që të potencohen subjekte të ndryshme politike, as individë të ndryshëm, se çfarë qëndrimi kanë në raport me situatën aktuale. Ne qëndrimin tonë si Lidhje Demokratike e Kosovës e kemi thënë dhe kjo ka qenë publike, përkrahja për mësimitdhënësit ka qenë e plotë, ata kanë qenë me përfaqësuesit e tyre jo prej individit, nëse flasim për përkrahje individuale dhe lojërat politike që janë bërë, kanë adresë. Ne i kemi parë se si luhet me sindikata dhe gjatë fushatës, edhe pas fushatës, edhe kur organizohen greva, ato janë publike, ne i dimë ato spektakle, në mënyrë të organizuar edhe para fushatës, edhe gjatë fushatës, por edhe tash me organizimin sindikal të grevave.

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk është dhe nuk ka qenë pjesë e kësaj.

KRYETARI: Faleminderit! Arbërie Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Qytetarë,

Sigurisht se diskutimi për çështjet që lidhen me arsimin është shumë i rëndësishëm dhe ka munguar deri më tani në këtë Kuvend. Por, edhe sot që po flasim në këtë situatë, nuk është se diskutimi do të ndihmojë apo do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së krijuar apo në përmirësimin e mangësive të shumta të sistemit të arsimit që janë sot dhe as që do të ndihmojë për të përkrahur mësimitdhënësit në punën e tyre, me të cilën do të përmirësohej cilësia në arsim dhe do të ngriheshin rezultatet e nxënësve.

Më 9 shkurt 2016 ky Kuvend ka miratuar një rezolutë për arsimin, ku ndër të tjera është përcaktuar që ministri i Arsimit duhet të raportojë në Kuvend çdo tre muaj, sot tre vjet e një muaj pas, asnjëherë ministri nuk ka raportuar për gjendjen në institucionet edukativo-arsimore. Sikur diskutimi të ishte se si ministri të dialogojë me Sindikatën që të tejkalohen këto mosmarrëveshje, madje të diskutohet dhe me përfaqësuesit e prindërve që të gjendet mënyra më e mirë për zëvendësimin e orëve të humbura, mund të ishte një gjë e pranueshme. Por ndarja e mëtejshme në mes të ministrit, gjegjësisht ministrisë dhe SBASHK-ut, gjegjësisht mësimdhënësve, është shumë e gabueshme dhe nuk sjellë asnjë rezultat pozitivë.

S'ka dyshim se orët e humbura duhet të zëvendësohen, madje duhet shumë më shumë punë, duhet angazhim e përkushtim në arritje të rezultateve të synuara, besoj se të gjithë pajtohemi me këtë. Por, vendimi i njëanshëm i ministrit që të zëvendësohen orët ka thelluar ndarjen në shkollat tona, në disa komuna, kryesisht aty ku qeverisin partitë që janë në pushtet, ka filluar zëvendësimi i orëve të humbura sipas vendimit, përderisa në komunat e tjera ky vendim nuk u zbatua. Pas miratimit të Ligjit për pagat, i cili i thelloi pabarazitë, i ndau faktikisht për herë të parë në mënyrë të padrejtë mësuesit e shkollave fillore me ata të shkollave të mesme të ulëta dhe të tjerëve, tani po thellohet ndarja dhe në mes të prindërve dhe mësimdhënësve. Prindërit sot janë në dilemë, a duhet t'i dërgojnë fëmijët në shkolla gjatë ditëve të pushimit, ashtu siç ka paraparë ministri i Arsimit me vendimin e tij, apo duhet të mos i dërgojë ata në shkolla gjatë këtyre ditëve ashtu siç po kërkon Sindikata, gjegjësisht mësimdhënësit. Dhe, në këtë situatë duhet të mos harrojmë se si erdhëm paraprakisht, pra, nuk është diçka e rastësishme.

Vetë fjala e kryetarit të Kuvendit, zotit Veseli, sot kur u paraqit si ndërmjetësues e zgjidhës i situatës së krijuar, ashtu dhe më 1 shkurt, ku pas 3 javëve të humbjes së mësimit gjatë grevave, kur lajmëroi se do të ndërpritet greva dhe të hënën, më 4 shkurt, do të fillojë mësimi, vetëm sa tregon ndërhyrjen e skajshme në shkollat dhe partizimin e tyre dhe se kjo është një betejë krejtësisht politike dhe se mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit pa të drejtë janë përfshirë në këtë gjendje të krijuar. Shumë nga mësimdhënësit tanë që nga paga e tyre blejnë material për punë për nxënësit, blejnë letra e markerë që mungojnë në shkollat tona, shumë nga prindërit që mbështesin mësimdhënësit e shkollat në të gjitha format, si në formën financiare, kontributet vullnetare dhe në forma të tjera, janë përfshirë pa të drejtë në këtë betejë që, në fakt, nisi nga vendimi i Qeverisë Haradinaj për të rritur pagat për vete, me arsytimin se u duhet të blejnë kravata. Nga nevoja e Kabinetit Qeveritar për kravata pastaj pasuan grevat e njëpasnjëshme, vazhduan ndërhyrjet partiake pa asnjë parim e profesionalizëm, e si gjithnjë pasojat do t'i bartin nxënësit tanë. Dëmi tashmë është bërë, asnjëherë orët e humbura nuk e kanë efektin e orëve të rregullta, këtë e dinë të gjithë punonjësit e arsimit dhe besoj se e dinë edhe prindërit.

Që në fillimin e punës në Ligjin për pagat kanë qenë të dukshme tendencat që buxheti i vendit, taksat dhe kontributet e qytetarëve janë përdorur për interesa klienteliste e partiake. Ndonëse kërkesat e Sindikatës për rritje të koeficientit kanë qenë të hershme dhe që nga fillimi, ato nuk

janë marrë parasysh. Unë personalisht, e ndodh që edhe dikush tjetër këtu nga deputetët, më 8 nëntor 2018 kam propozuar një amendament për Projektligjin për pagat, me të cilin kam kërkuar që koeficienti i pagës bazë për punëtorët/nëpunësit e sistemit të arsimit të jetë 20% më i lartë se sa ai i përcaktuar me projektligj.

Por, as kjo s' u mor parasysh, u deshën të humbin 15 ditë pune që të arrijmë në të njëjtën pikë. E vërteta është se asnjë qeveri e pasluftës nuk iu përkushtua me vendosmëri ngritjes së cilësisë në arsim. Asnjëra nga to nuk ndërmori hapa konkretë për të përmirësuar kushtet e mësim nxënies për nxënësit dhe kushtet e punës për mësimitdhënësit. Akoma sot në shkollat tona mungojnë gjëra, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Asnjëherë nuk iu kushtua kujdes kushteve të dinjitetshme për punë, të cilat rrjedhimisht do të ndikonin dhe në ngritjen e cilësisë në arsim. Edhe sot, nuk po flitet për përmirësimin e cilësisë në arsim, për krijimin e kushteve më të mira për punë, për kabinetet e laboratorët që akoma mungojnë në shkollat tona, për përfshirjen e fëmijëve në edukimin e hershëm, i cili është jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm jo vetëm për secilin prej fëmijëve tanë, por edhe për zhvillimin e vendit, për sigurinë e fëmijëve, por prapë po sakrifikohen fëmijët e mësimitdhënësit për shkak të ndikimeve partiake, për shkak të betejave në mes të individëve, për shkak të inateve dhe tendencës për të marrë merita.

Greva në arsim ka pasur dhe më herët, orët e humbura gjithnjë janë zëvendësuar, mësimitdhënësit nuk kanë hezitur të kryejnë punën e tyre, andaj unë i lus mësimitdhënësit që si zakonisht të gjejnë zgjidhje, i bëj thirrje ministrit, ministrisë, SBASHK-u dhe përfaqësuesit e prindërve, sepse edhe prindërit duhet të merren parasysh dhe mendimi i tyre duhet të merret parasysh në gjetjen e zgjidhjes, që të gjejnë zgjidhjen më të mirë dhe më të përshtatshme për fëmijët. Bëj thirrje po ashtu që të largohet presioni partiak nga mësimitdhënësit, të shtohet mbështetja për ta, sikurse dhe përgjegjësia për punë dhe kërkesat ndaj tyre në drejtim të profesionalizmit dhe punës që ata duhet ta kryejnë sipas detyrave të kanë marrë përsipër.

Dhe, në fund fare, dua të përmend një citat nga një letër që na ka dërguar kryetarja së Këshillit të Prindërve të komunës së Prishtinës, e cila e tregon shumë qartë situatën në të cilën ndodhen prindërit. Në fund të një letre që na ka dërguar ajo thotë:

“Në këtë situatë, si prindër, e vetmja që na ka mbetur të urojmë është që ky vit shkollor të mbarojë sa më parë dhe të mos përsëritet kurrë më një tjetër si ky! Uroj që të gjeni kurajë për t'i dhënë fund kësaj rrëmuje, kësaj rrëmuje që e krijuat vetë!”. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar qytetarë të Kosovës, posaçërisht mësimitdhënësit e mësimitdhënëse,
Të nderuara kolege,
Të nderuar kolegë,

Ky debati ynë për çështjen e grevës së punonjësve të arsimit po bëhet një debat interesant, i cili edhe po e kalon temën për të cilën ne jemi takuar, për çfarë është thirrur edhe ky debat.

Natyrisht që e drejta e grevës është e drejtë demokratike, pra një instrument i qytetarëve për të realizuar qëllime të caktuara gjatë punës së tyre, posaçërisht punëmarrësve. Ne kemi pak një traditë më të vogël sa i përket organizimit grevist, se sa shtetet e tjera perëndimore, unë gjatë këtyre ditëve, edhe për shkak të përvojës time personale, por edhe për shkak të kontakteve kam kontaktuar edhe sindikalistë në Zvicër dhe të tillë edhe nga Sindikata UNIA, ku jam përpjekur që njohuritë e mia për organizimin sindikal t'i thelloj. Dua të ndaj një përvojë, respektivisht disa njohur që kanë të bëjnë me to. Zakonisht kur organizojnë sindikatat greva në sektorin privat kujdesen që ato të zhvillohen në një kohë të punës, ku e dëmtojnë sa më pak punëdhënësin, por japin një sinjal të qartë. Në rastet kur grevat organizohen gjatë gjithë ditës, atëherë Sindikata është e obliguar që atyre që i ka ftuar në grevë, t'ua paguajë ditën, sepse askund në botë punëdhënësi nuk paguan askënd për punën që nuk e ka bërë. Kjo çështje është e rregulluar kështu edhe te ne me ligj, edhe pse nuk është e përcaktuar qartë, por ajo që dihet nga orët e humbura, pra orët e humbura nuk i kompenson askush, as në sektorin privat, as në sektorin publik.

Tani cili është kontesti, sepse po diskutojmë rreth e rrotull, ndërsa nuk po diskutojmë saktësisht dhe qartë për çka është fjala. Kemi grevën e punonjësve të arsimit, të cilët kanë kërkuar që të rriten rrogat e tyre, një kërkesë jashtëzakonisht e drejtë, e sidomos për një sektor i cili ka kontribuar jashtëzakonisht shumë, kam parasysh sidomos kohën para luftës kur mësuesit tanë, mësueset tona, pa pagesë fare kanë dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh që ta mbajnë arsimin në Kosovë. Kërkesa e tyre ka qenë shumë e drejtë dhe është përkrahur edhe nga ne si Parti Socialdemokrate. Pastaj, çfarë ka ndodhur pastaj, ka ndodhur që ne kemi bërë Ligjin për paga, i cili natyrisht që nuk është prej ligjeve më të mira, po krijon njëfarë rregulli, edhe marrëveshja vjen edhe si çështje e miratimit të Ligjit për paga, ku punonjëseve të arsimit u rriten rrogat, prandaj unë pak po habitem me kolegët e mi të opozitës, të cilët Ligjin për paga, pra kur ka qenë fjala për rritjen e rrogave të punonjësve të arsimit nuk kanë votuar fare dhe tash, në fakt, nuk po thonë asgjë, po thonë këtë, që po ne ia mbajmë anën Sindikatës, të punëtorëve të arsimit, po merrni vesh vetë. Hajde te diskutojmë konkretisht, cili është konteksti këtu?

Pra, Sindikata e Arsimit po thotë që ne nuk dëshirojmë t'i mbajmë orët, të cilat i kemi humbur tani shtrohet një pyetje edhe para ju deputetëve, edhe para qeverisë, para ministrit të Arsimit, cila është alternativa? Ka dy alternativa këtu, njëra që orët të kompensohen, e që si duket dëshirojnë edhe prindërit, edhe pjesa më e mirë e arsimtarëve, por edhe nxënësit, pra kjo është njëra anë dhe, ana tjetër është nëse dëgjojmë çfarë thonë drejtuesit e Sindikatës, që orët që kanë kaluar, kanë kaluar dhe vazhdojmë kështu. Jo, alternativa është kjo: ose bëhet kompensimi e që po kërkohet nga të gjithë, po kërkohet edhe nga ju deputetë e deputetet, ose Ministria e Arsimit t'ua ndalë pagesat për ato tri javët që nuk kanë punuar dhe pastaj jemi në rregull, të mos i mbajnë.

Pra, s'ka alternativë tjetër, kjo është logjika, edhe kjo është e vetmja alternativë, për orët që nuk kanë punuar, s'ka rroga. Shikoni, edhe grevat e kanë një kosto, ai që hyn në grevë për ta realizuar një qëllim, e ka një kosto, pra nuk punon, duhet ditur që s'merr para për atë kohë që s'ka punuar, por edhe punëdhënësi e ka një kosto. Tash në rastin tonë kemi të bëjmë me nxënësit, nxënësit janë humbësit kryesorë të kësaj beteje, nuk është Ministria e Arsimit, se nuk po humb kurrëgjë, po edhe Sindikata po do të mos humbë. Kështu që alternativa për mendimin tim është kjo, që punonjësit e arsimit, ata burra e gra, djem e vajza, të rinj e të vjetra që kanë mbajtur gjithë arsimin në Kosovë, që kanë punuar për vite të tëra pa pagesë që t'i mbajnë edhe këto orë të humbura, sepse qëllimin për të cilin e kanë mbajtur grevën e kanë arritur, pra qëllimi është i arritur. Unë mendoj që ministri i Arsimit në këtë rast u ka bërë një të mirë edhe punonjësve të arsimit, edhe Sindikatës, duke u dhënë mundësinë që të mos ua ndalë rrogën për orët që s'kanë punuar, por thjesht t'ua mundësojë që t'i marrin rrogat dhe në të njëjtën kohë, të përfitojë edhe sistemi arsimor në Kosovë, po mbi të gjitha të përfitojnë nxënësit.

I dëgjova disa kolegë e kolege që thanë që orët e humbura nuk kompensohen kurrë më, sepse nuk është njësoj si orët e rregullta, edhe orët që mbahen më vonë. Kjo s'është e vërtetë, zonja dhe zotërinj, unë jam pedagog social me profesion, kam studiuar këtë pjesë, kam magjistruar në këtë pjesë. Nuk është e vërtetë që nuk kompensohet mësimi, mësimi kompensohet jashtëzakonisht mirë, për t'u kompensuar mirë, nevojitet vullneti i arsimtarëve, i prindërve dhe nuk ka asnjë pengesë reale që mësimet e humbura të mos kompensohen. Prandaj, unë po ju ftoj edhe një herë, këtu kemi dy alternativa: o të mbahet mësimi i rregullt, o t'u merren rrogat atyre që s'kanë punuar që është pasojë normale. Unë jam për organizim sindikal, jam për sindikata, jo sindikata të salloneve, jam për sindikata të mirëfillta që mbrojnë të drejtat e punëtorëve, që angazhohen për to, por jam që të jemi edhe konstruktiv. Mendoj që nuk është në rregull që të gjithë qytetarët e Kosovës të paguajnë për rritjen e rrogave të arsimtarëve, ndërsa rroga t'u rritet vetëm atyre. Ju të gjithë thatë që po, le të ulen bashkë dhe le të bisedojnë, edhe ne s'po themi ndryshe, aq më mirë që kryetari i Kuvendit tha që po, si dhe një informacion që ka një gatishmëri të merren vesh. Po mendoj që kjo është pozitive, na e lehtëson edhe neve debatin. Ajo që duhet të merremi vesh ndoshta përveç këtyre dy alternativave që thashë, është edhe në çfarë kohe të kompensohen orët e humbura, por jo më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Donika, fjala për ju, edhe te Daut Haradinaj regjia.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Desha shumë shkurt të them që kjo seancë nuk do të prodhojë asgjë, sepse çështjet të cilat ne po i çelim, po i diskutojmë edhe po i trajtojmë, në fakt janë të rregulluara me ligj. Ministri i ka të gjitha kompetencat dhe është i obliguar ta zbatojë ligjin, prandaj ne veçse po humbim kohë me një debat, i cili është shterpë dhe nuk do të prodhojë asgjë.

Është mirë që të gjitha institucionet t'i marrin vendimet e veta sipas ligjit, çështja është edhe në gjykatë, prandaj edhe gjykata do të sjellë një vendim. Ajo çka dihet është që fëmijët kanë humbur më së shumti dhe, meqë është kështu, është e pritshme dhe nuk ishte dashur ta provojë çdonjëri nga ne ta konfirmojë që duhet t'i kompensojmë në një formë ose tjetër këtë humbje, e cila u është bërë fëmijëve. Mirëpo, në anën tjetër, edhe SBASHK-u, duke e ditur që u janë rritur rrogat dhe tanimë janë në fazën kur në njëfarë forme duhet të gjejnë mënyrën për t'i kompensuar orët e humbura, është mirë të gjendet një kompromis dhe kjo seancë të marrë fund këtu, të mos humbet kohë, pra që të zbatohet ligji dhe vendimet, të cilat i ka marrë ministria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në qoftë se s'ka gatishmëri të deputetëve, ne shkojmë deri në fund, pastaj, kini parasysh, të mos shkojmë në fund e pastaj të themi hajde tash të fillojmë, pasi të zbrazemi, për arsye se duhen vota.

Do të shkojmë në bazë të Rregullores, jo në fund pastaj të mendojmë ta ndërrojmë drejtimin e seancës. Vetëm pak, Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Kryetar!

Po e shoh që je vazhdimisht nën presionin e seancës së dytë, e keni caktuar një seancë në orën 14:00, po ashtu të jashtëzakonshme, pa kurrfarë nevojë dhe tash po na bëni presion këtu, pas vendimit që e keni marrë për këtë seancë, a të flitet a të mos flitet, e para. E dyta, i kisha sugjeruar ministrit të Arsimit që t'i marrë transkriptet e krejt këtyre debateve dhe ta botojë një libër me titull "Përrallat e Parlamentit". Shumica absolute e këtij Parlamenti, duke përfshirë edhe kryetarin e Kuvendit, kur kemi qenë fëmijë, 99% prej neve kurrë përralla s'kemi dëgjuar, edhe me lezet shumë të madh po i dëgjojmë përrallat e njëri-tjetrit sot këtu në Kuvend. Po, me të njëjtin lezet e kënaqësi po na i dëgjojnë këto përralla edhe Sindikata mafioze e Arsimit të Republikës së Kosovës. Ajo nuk është sindikatë, ajo nuk përfaqëson arsimin, ajo nuk i përfaqëson mësuesit dhe profesorët e devotshëm të këtij vendi, po është një grup i mafiozëve të cilët shfrytëzojnë paratë e sindikalistëve dhe dalin e bëjnë kërcënime, e bëjnë shantazhe, dhe bëjnë politikë në Republikën e Kosovës.

Deri më sot, e tha Fatoni shumë mirë, çështjen e organizimit të sindikatave qysh bëhet në çdo vend normal të botës. E tha edhe deputeti Driton Çausi se me çfarë kërcënimi ka ardhur kryetari i sindikatave dhe ka raportuar në Komisionin për Arsim të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Me çfarë fodullëku, me çfarë budallallëku ka ardhur dhe ka thënë se nuk bëhet nami edhe po të humbë një vit shkollor. Krejt këtu çka flasim ne, nuk guxojmë të flasim të vërtetën se veç mendojmë se cilët arsimtarë po i mashtrojmë e kush ka për të na votuar në zgjedhjet e ardhshme, sepse nuk jemi ndërtuar themel, bazament të vizionit dhe të ardhmërisë së fëmijëve tanë, por jemi duke folur këtu për vota. Jemi duke e gjuajtur partia partinë, jemi duke e gjuajtur një ministër i cili është treguar me fakte, me dokumente që është njëri nga ministrat më të suksesshëm të Qeverisë aktuale të Republikës së Kosovës. Çka ka të bëjë ministri i shkretë, të

rrihet me boksa me sindikalistët, ata që i marrin pagesa nga 1900 e 2000 euro sindikalistët dhe dalin e bëjnë shantazhe jo do ta vazhdojmë grevën dhe e kanë ditur se ishte Ligji për paga në procedurë të Kuvendit.

E ka ditur Sindikata që do të bëhet rritja e pagave dhe në fund dolën e arritën një marrëveshje politike, vetëm për të dalë përpara kamerave televizive. Kjo sindikatë e turpit të Republikës së Kosovës, kjo sindikatë e turpit që kurrë nuk është marrë me problemet me të cilat duhet të merret një sindikatë, ka bërë vetëm marrëveshje politike me liderë të ndryshëm të partive politike, në fushata elektorale që kund në botë nuk ndodh sindikata të bëjnë memorandume politike. Kanë bërë me Hashim Thaçin, kanë bërë me liderë të tjerë politikë, s'po guxoj t'ia përmend emrin se kanë bërë marrëveshje politike edhe me kryetarin e Kuvendit, z. Kadri Veseli. D.m.th. marrëveshje politike kush voton sindikata. Pse bëjnë marrëveshje politike?

Sepse këta nuk merren me kushtet mizerje në të cilat punojnë shkollat tona. Këta nuk merren me kushtet mizore në të cilat e zhvillojnë procesin mësimor arsimtarët dhe profesorët tanë. Këta kurrë nuk janë marrë me debatin çka ka pasur nevojë Kosova për të gjitha ato universitete publike, të cilat janë hapur vetëm për shkak të votave. Le të shkoj sindikata dhe le të shikojë Universitetin Publik 'Hasan Prishtina' dhe le ta shikojë se kur të futeni brenda korridoreve të këtij universiteti, çdo gjë i vjen era si stacionit të trenit në Murgë në Cerovikë. Nuk i vjen era universitet, nuk ka ndriçim, nuk ka libra, nuk ka kushte për zhvillimin e mësimin. Sindikatat nuk flasin që fëmijët tanë nëpër çerdhe janë të stërbushur me morra. Sindikatat nuk flasin që në çerdhet tona publike në një dhomë janë 24 fëmijë. Sindikatat nuk flasin që në një klasë të mësimin janë 35 nxënës dhe kemi shumë nxënës që e zhvillojnë mësimin pa dritare, pa ajrosje. Sindikatat nuk kanë folur kurrë për mungesën totale të librave shkollorë që e kanë studentët tanë.

Akoma studenti në shekulli XXI, studenti i Republikës së Kosovës në universitetet tona marrin shënime me dorë, profesori flet dhe shumë profesorë ua imponojnë shitjen e librit të tyre. Thotë o ke për të ma blerë librin, o nuk mund të hysh në provim, plus që këta studentë marrin shënim. Prandaj, që ta përfundon fjalimin tim, ministri le ta zbatojë ligjin, le t'ua ndalë rrogën këtyre kapadainjëve, sepse sindikata duhet të garantojë rrogat e grevistëve kur organizon greva dhe i fut njerëzit nëpër greva dhe këta krerët e sindikatës duhet nga prindërit të paditen juridikisht në gjykatat e Kosovës për terrorin psikik që ua kanë shkaktuar fëmijëve tanë gjatë tri javëve. E kanë ditur epilogun, e kanë ditur përfundimin, e kanë ditur që në Ligjin e pagave të gjithë deputetët kemi kërkuar rritjen e rrogave të arsimtarëve dhe u bë rritja dhe çka bënin këta? Vazhdonin grevë, bënin shantazh, bënin kërcënime, sikur sot që nuk i vjen marre kryetarit të Sindikatës të thotë që unë në qoftë se bëhet zëvendësimi i orëve të mësimin, ne do të futemi prapë në grevë. Çka do të thotë kjo? Kjo është terror psikologjik ndaj fëmijëve dhe ndaj prindërve të fëmijëve. Nuk po mundka Sindikata të ulet me prindër, me nxënës, me arsimtarë dhe të gjejë një zgjidhje të thotë cila do të ishte alternativa më e mirë e kompensimit të orëve të mësimin dhe pastaj të dalë me një konkluzion dhe me një vendim.

Prandaj, zoti ministër, nga unë si deputet kështu, pavarësisht se unë nuk flas kurrë të marrë rroga, ata njerëz të cilët e drejtojnë Kosovën, ato sindikata që na i terrorizojnë fëmijët tanë në këtë mënyrë, kurrë votën e tyre unë mos e paça. Zbatoje ligjin dhe s'kemi pasur fare nevojë ne të të terrorizojmë me gjëra të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Foltorja është për deputetë. Përgjegjësinë e mban deputeti, jo Kuvendi, veç ta kemi parasysh. Këto, po më vjen keq, edhe pse ndoshta nganjëherë edhe po duhet të reagoj.

Deputetë të nderuar, radhitja e cila ka qenë e deputetëve nuk ka humbur, edhe pse atje ju vihet se është fshirë në sistem, po e kemi. Do të thotë radhitjen.

Zonja Bunjaku, ju keni kërkuar replikë, nëse e mora vesh, se fjalën e keni marrë. Të paktën kështu ma thanë. Replikë, a është kështu?

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Unë fjalën time e kam dhënë në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Tani mund të shfrytëzoj tash minutat si deputete. Besoj se jemi në rregull.

KRYETARI: Jo, vetëm se administrata, ata më thanë se ka folur se deputete.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Jo unë ka folur në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike.

KRYETARI: Po, po e keni edhe të drejtën e fjalës.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Ok! Nuk do të zgjatem shumë, do të mundohem të flas sa më shkurt.

Atëherë, nëse ata të cilët e kanë thirrur këtë seancë, edhe parafolësi im këtu për mos t'ia përmendur emrin, u bë avokat edhe tregoi se i kemi terrorizuar ministrin dhe fëmijët, atëherë pse e keni thirrur seancën, kur qysh në fillim në fjalën time, unë thash që kjo seancë, ky debat ka qenë i paarsyeshëm dhe ky problem me Ministrinë dhe SBASHK-ut, ka qenë jo i drejtë të vijë dhe të debatohet në Kuvend, sepse problemi është në mes të Ministrisë dhe sindikatave. Nëse Sindikatat janë aq të papërgjegjshëm dhe nuk po e kryejnë punën e tyre ashtu siç duhet, atëherë janë mësimsdhënësit ata të cilët duhet të reagojnë dhe duhet të dorëheqen nga Sindikata. Deri më sot, unë nuk ka dëgjuar në asnjë shkollë që mësimsdhënësit kanë bërë thirrje që duan të tërhiqen prej Sindikatës. Ne këtu nuk po bëjmë politikë, ne këtu po lypim llogari për orët e humbura, për dëmin që iu ka shkaktuar fëmijëve tanë dhe në këtë rast, kjo situatë, deri tash këtu që po debatojmë, nuk është dashur të vijë, të lidhet një realisht.

Mospajtimet ndërmjet SBASHK-u dhe ministrit, u tha që ne si Komision i Arsimit e kemi përkrah ministrin. Sa për informatën tuaj dhe për sqarim për qytetarët e Republikës sonë, unë nuk kam qenë pjesë e atij takimi dhe nuk e kam dhënë mendimin tim, as unë, as kolegu im që jemi në Komision të Arsimit, s'kemi qenë prezentë në atë takim dhe nuk e kemi dhënë fjalën tonë si Lidhje Demokratike e Kosovës. Unë edhe një herë po bëj thirrje nga këtu, përgjegjësia nuk është tani vetëm e këtij ministri këtu që është dhe nuk do me thënë që ne po e flasim atë çka mendojmë, dhe po i biem në qafë ministrin, por ne po e lusim ministrin, le të ulet bashkërisht me SBASHK-un, le t'i zgjidhë problemet dhe nëse SBASHK-u nuk i përfaqëson mësimdhënësit, unë i bëj thirrje të gjithë mësimdhënësit le të largohen nga SBASHK-u. Deri sot unë nuk kam parë asnjë reagim që mësimdhënësit kanë thënë do të largohemi prej Sindikatës dhe krejt ky debat që ju po thoni është i paarsyeshëm, unë e thash në fillim fjalën time. Ne si Komision i Arsimit normalisht që sa herë që ka nevojë do të mblidhemi dhe do të debatojmë, do të diskutojmë dhe do t'i japim propozimet tona.

Ne këtu përfaqësojmë grupet tona, dhe mendimet tona dhe askush nuk mund të ndikojë në mendimin apo në propozimet që ne i bëjmë si Lidhje Demokratike e Kosovës. Prandaj, absolutisht nuk po më pëlqen tendenca e njërit dhe tjetrit duke e hedhur fajin prej një partie në partinë tjetër, kur faji qëndron pikërisht në Qeverinë, sepse kaq shumë iu dhimbtën koeficienti apo mjetet për t'i rritur për mësimdhënësit, një koeficient të merituar dhe nuk ju dhimbsën apo nuk reaguat ju si Qeveri për rritjen e pagave për vetë Kryeministrin, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët e kështu me radhë. Andaj për mësimdhënësit është më se e obligueshme edhe ky koeficient që tani e kanë duhet të rritet edhe më shumë. Dhe, unë jam e gatshme dhe do të bashkëpunoj me Komisionin e Arsimit dhe me ministrin, po përgjegjësia bie mbi Qeverinë dhe mbi Ministrinë e Arsimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo është situata në të cilën jemi. Po vazhdoj në bazë të një radhitjeje e cila ka qenë. Albert Kinolli ose Duda Balje, kanë kërkuar falje. E keni pasur të kërkuar, Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem predsedniče!

Ja mislim da smo puno pričali o ovome, i mislim da absolutno hoće na početku svoga govora da se izvinim svim učenicima Kosova što se kao prvo bez njihove nikakve krivice tri nedelje nisu išli u školskim klupama, i što i sada držimo u neizvjesnost jer svako od njih zove i pita da li će u subotu da ide u školu, da li će imati prolečni raspust.

Mislim da su sve ova neslaganja upravo lomi na njihovim leđima i od njih danas kao poslanica tražim jedno veliko izvinjenje. Definitivno, Komisija za obrazovanje podržala minsitra i mislim da u Komisiju, ukoliko toje većinom izglasano, mislim da o nadoknadi časova nemam ni šta da govorim, abolutno podržavam sve roditelji koji traže da njihova dece dobiju znanja koju su trebala da dobiju u ta tri nededelje kad se štrajkovalo, ali absolutno smatram da od Sindikata ne

trebamo da pravimo neke neprijatelje. I ti ljudi unutar tog sindikata ipak ljudi koji su želeli da se izbore za neka svoja prava.

Definitvno, trebamo da sednomo i da pričamo s njima, i Sindikat treba da poštuje odluku roditelja, i odluku dece koje oni predstavljaju, i naravno odluku samog Ministarstva. Treba da nađemo modus što pre, jer ovakva vrsta neizveznosti samo i definitvno deluje negativno na učenike i na sve učenike Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Selmanaj, urdhëro!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Unë po e shoh krejtësisht të panevojshme thirrjen e kësaj seance, po megjithatë tash kur thirret kjo seancë e panevojshme, atëherë duhet dhënë arsyet që ne i vlerësojmë si të panevojshme. Janë disa arsye. E para ka të bëjë që kjo çështje është në gjykatë. Çështja e zbatimit të vendimit të ministrit ka qenë në Gjykatë Themelore. Gjykata Themelore e ka hedhur poshtë, por më pas Sindikatat janë ankuar në Apel dhe Apeli akoma s'ka marrë vendim për këtë çështje. Ne po diskutojmë për një çështje e cila është në proces gjyqësor.

E dyta, ne po harrojmë që kemi miratuar disa ligje në këtë Kuvend të Kosovës dhe të tillët duhet t'i respektojmë. Unë vërtet i takoj një partie politike që e ka ideologjinë e saj të djathtë dhe më së paku mund të flasë për sindikata dhe për tema të ngjashme, por megjithatë ne interesohemi që ligjet e aplikueshme në Kosovë të zbatohen. Ne kemi Ligj për grevën, ne kemi Ligj për organizimi sindikal në Kosovë, ka konventa ndërkombëtare për këtë punë. Organizata Ndërkombëtare e Punës ka njëzet dokumente që i ka nxjerrë për liritë dhe të drejtat e punëtorëve për organizime të tilla. Të dëgjosh sot këtu fjalë ku kërkohen edhe pagat t'u ndalen atyre që bëjnë organizim sindikal, jo është paradoksale, po është për të ardhur keq.

Po provojmë këtu të simplifikojmë, ta thjeshtojmë që gjendja në arsimin sot në Kosovë është si rezultat i këtyre orëve të humbura. Po nuk qëndron kjo! Problemin themelor unë e kam që edhe sot vazhdojnë të humbin orët. Edhe kur por zhvillohet kinse mësimi i rregullt, edhe sot mësuesit i lëshojnë më herët nxënësit.

Testi i PISA-s nuk na ka dalë keq si rezultat ose vlerësimi i PISA-s nuk na ka dalë si rezultat që ne i kemi humbur këto orë dhe më pas tash po provojmë që t'i ... nëse i humbim këto orë, humbet tabela e shumëzimit, humbet ajo. Po mos se kjo është joserioze.

Unë mendoj që ne jemi në situatë ku e kemi shkaktuar vetë këtë problem dhe kush janë vetë, mendoj ju që i keni politizuar shkollat, ju që keni shkatërruar sistemin arsimor në Kosovë. Burimin e këtij problemi, a e di ku është? Është te memorandumimi ku ju i keni thënë sindikatave do t'ua rrisim pagat 30 për qind, shkruan qartas. Ata kanë kërkuar të drejtën e vet që të realizohet

ajo. Ju nuk keni dashur, ose së paku s'keni pasur vullnet në atë kohë dhe ata e kanë zgjedhur grevën si instrument më legjitim të mundshëm. Ligji ua garanton këtë. Konventat ndërkombëtare e garantojnë këtë. S'po lëshohem në atë që a ka qenë e drejtë kërkesa e tyre apo jo? Nuk dua të lëshohem në të, por tendenca për të provuar që tash të gjithë fajin t'ia lësh organizimit sindikal dhe shfrytëzimit të instrumenteve, kjo është në kundërshtim edhe me vetë përpjekjet tona çka po duam të nderojmë. Secili në Kosovë që është pjesë e një organizimi sindikal, ka të drejtë t'i shfrytëzojë mjetet e tij dhe greva është njëra nga to.

Tash, paaftësinë e Qeverisë për t'u dhënë zgjidhje problemeve me kategoritë e caktuara në shoqëri, po provoni t'i sillni në Kuvend dhe ta trajtoni madje, shumica prej juve të shndërroheni në zëdhënës kush më tepër është zëdhënës i sindikatave. Po nëse ju e paskeni pasur zgjidhjen e këtij problemi, pse e keni thirrur këtë seancë? Nëse kryetari i Kuvendit thotë për një orë kjo punë kryhet, a s'komunikoni ju brenda Qeverisë? A nuk është kryetari i Kuvendit lideri i koalicionit qeverisës? A nuk flet Nisma me PDK-në? Nëse këta e keni pasur për një orë, po pse na keni torturuar sot të vijmë këtu dhe pse po na torturoni edhe tash edhe më shumë që ne të bisedojmë për këtë temë?

Unë mendoj që cilado zgjidhje që do të jetë, edhe nëse merreni vesh sot pas një ore me sindikatat, nuk keni bërë zgjidhje asgjë. Ju po vazhdoni edhe më tutje mbajtjen e politizimit të skajshëm dhe partizimit të shkollave dhe cilësia e arsimit vazhdon të jetë e tillë.

Të mos fokusohemi në këtë kontekst. Të fokusohemi qysh ta rrisim cilësinë në arsim, qysh ta përmirësojmë nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në këto objekte, po jo të provohet që përmes drejtorëve të shkollave, përmes arsimtarëve të politizuar dhe përmes sindikatave që më shumë kanë karakterin politik, ta shkatërroni edhe më tutje këtë sistem të çmueshëm në arsim.

Mos prekni në elemente sindikale, sepse ia kemi rregulluar vetë me ligj. Mund ta sjellim Ligjin për grevat, mund ta sjellim Ligjin për organizimin sindikal edhe t'i vlerësojmë ato që nuk kanë nevojë, nuk mund të realizojnë grevën si instrument, por të provosh tash, sepse kjo ka një pasojë tjetër, kjo merret edhe si shantazh. Do të thotë ju po i kërcënoni sindikatat në Kosovë, se çfarëdo veprimi që mund të ndërmerri, shteti ka instrumentin tjetër që më pas ju detyron juve. Jo, organizimi sindikal nuk e duron këtë. Nuk e duron këtë. Ata mund të marrin vendime të çfarëdo natyre, në përputhje me ligjin për organizimin sindikal dhe shfrytëzojnë instrumentet e tyre, po s'mund t'i nënshtrohen detyrimit të askujt, as vendimit arbitrar që mund të jetë, sado i drejtë që mund të duket nga ana e Ministrisë, sepse po flasim për të drejtat e garantuara me konventa ndërkombëtare.

Prandaj vullneti juaj nuk guxon të tejkalojë këto instrumente, prandaj po ju lus që fokusi jonë të mos të jetë në orët eventualisht të humbura, por si ta përmirësojmë sistemin dhe cilësinë në arsim

dhe të mos i humbim edhe këto orë që ndoshta sot këtu sa po flasim këtu, dikush po humb orë atje. Faleminderit!

KRYETARI: Arbër Rexhaj, urdhëro!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Nuk po them që kjo seancë është thirrur në formë të panevojshme, por po them kjo seancë përnjëmend është e turpshme. Sepse këtu po kërkohet prej deputetëve të Kuvendit të Kosovës pra të japin mendimin a duhet të zëvendësohen orët apo nuk duhet të zëvendësohen orët? Pra, të mbahet kjo ana e ministrit apo të mbahet ana e SBASHKU-ut? Minsitër, çfarë përgjigje po doni? Sigurisht që duhet të zëvendësohen orët. Por, kjo seancë e thirrur nga Nisma për zëvendësimin e orëve të pambajtura, sigurisht që ka arsye objektive. Unë e thash edhe më parë është e turpshme në një seancë të thirret nga një subjekt politik që e udhëheqë arsimin në Kosovë, dhe e cila turpësisht gjithandej në ministri, nëpër komuna, pa përjashtim, ku udhëheqë, nepotizmin dhe klientelën e ka të shquar, tejet të shquar. Si subjekt politik me të cilin njihet si sekret publik më, është punësimi klientel. Dhe jo vetëm NISMA, po krejt PAN-i.

Ministri i Arsimit duhet të dalë në këtë Kuvend dhe të na thotë një gjë të mbarë që ka bërë pos punësimeve klientele. Po ashtu, ky ministër duhet të japë edhe përgjegjësi për këto ekskursionë që po i quaj unë për punëtorët, të cilët i ka dërguar njëherë në Budva pastaj në Shqipëri e me të cilën, pra në fund kur është paguar është paguar katërfish më shtrenjtë. Përnjëmend, këtu do duhet të aktivizohet edhe Prokuroria.

Në anën tjetër, kjo seancë është thirrur për t'u tallur me fëmijët tanë. Hiç më larg se dje, djali im më pyeti; babi a të shkojë në shkollë? Do të thotë më pyeti për javën e kaluar, më falni. Do të thotë nuk e dinte se a do duhej të shkonte në shkollë apo jo.

Djalin e kam në klasën e pestë. Unë nuk dija sesi t'i thosha, të shkojë në shkollë apo të mos shkojë në shkollë. Tash po e shtroj si problem individual, por këtë e kanë të gjithë prindërit.

Njëjtë është edhe për vajzën, veçse është në klasën e parë dhe nuk di të bëjë kësi pyetjesh.

Tash shtrohet pyetja; a duhet të zëvendësohen orët e humbura? Sigurisht se po. Pse na keni thirrur këtu? T'i përgjigjemi kësaj. Po, nuk ka nevojë për përgjigje. E vërteta qëndron krejt ndryshe; SBASHK-u që e bëri skllotë kryeministrin Ramush Haradinaj dhe krejt Qeverinë, e si vartëse e drejtpërdrejtë e Thaçit dhe e PDK-së, fatkeqësisht, mbajnë një anë që thotë që orët e humbura nuk duhet të zëvendësohen, aq pafytyrësisht madje.

Veç kërkesave për rritje pagash, defilimeve me PAN-in gjatë fushatë elektorale, SBASHK-u duhet të na tregojë edhe për çka eksiton. Të na e thotë se a e ka mbrojtur të drejtën e punëtorëve

të arsimit ndonjëherë, apo të vetmen gjë që e ka bërë ka qenë sfilata me PAN-in dhe kërkimi për rritjen e pagave.

Si Lëvizje Vetëvendosje nuk kemi qenë kundër rritjes së pagave, të mos keqkuptohemi. Mirëpo, ka dhjetëra e qindra raste në Kosovë, ku janë shkëlur të drejtat e punëtorëve në arsim dhe nuk ka asnjë konferencë të SBASHK-ut e cila ka dalë dhe na i ka thënë troç ato.

Grevat nuk bëhen vetëm për rritje të pagave siç thashë, por edhe kur u shkelen të drejtat dhe fatkeqësisht SBASHK-u pra, nuk i përfaqëson mësimdhënësit, madje unë besoj që mësimdhënësit ndihet të fyer me përfaqësimin të cilin ua bënë SBASHK-u.

Edhe pse normalisht që anëtarësia e kësaj sindikate normalisht që janë mësimdhënësit, mirëpo ata falë juve si Qeveri dhe falë SBASHK-ut po krijohet një ndarje shumë e thellë mes mësimdhënësve, prindërve dhe kështu një njëfarë formë po krijoni atë që ne e quajmë absurditet.

SBASHK-u krejt aktivitetet që i organizon ca ndeja edhe organizime festive të festave të ndryshme. Unë nuk kam parë që ka bërë diçka tjetër SBASHK-u. Prandaj, Ministria e Arsimit dhe SBASHK-u sot fatkeqësisht po guxojnë të tallen me fëmijët tanë dhe duelin e ringut e kanë zgjedhur këtu krejt në heshtje.

Kryetari I kuvendit më herët tha, pra Kadri Vesli që në fund nuk do të mbetet asnjë deputet. Ju e keni ditur që nuk do të mbetet asnjë deputet. Madje-madje ju e keni ditur që në fund do të votohet as ajo rezolutë.

Shihni ku është PAN-i, shihini ulëset ku i keni. As deputetët nuk i keni aty. Shumë pak prej jush janë këtu. Prandaj, ju vet në fund do të krijoni një rast konfiziteti ku njëri prej jush do të dalë tash dhe do të thotë; unë jam heroi, sepse orët e humbura po i zëvendëson kjo parti politike.

Në fakt ne e dimë të gjithë që prej drejtorëve të shkollave, edhe pse ka përjashtime, të gjithë pra janë të partishëm në krejt Republikën e Kosovës, dhe kjo është e turpshme. Krejt janë të partishëm. Mos të të flas për mësimdhënësit, me përjashtime gjithmonë, krejt mësimdhënësit e Republikës së Kosovës të cilët kanë hyrë në punë, janë mësuar keq nga Thaçi atëherë dhe më pastaj e kanë vazhduar edhe subjektet e tjera politike.

Prandaj, krejt çka kam pasur sot këtu ka qenë në një farë forme një lloj matje elektorale në këtë sallë edhe pse pyetja, edhe njëherë po e përsërisë; a duhet të zëvendësohen orën apo nuk duhet, edhe pse orët e humbura normalisht që nuk zëvendësohen me efektin e njëjtë, mendoj që është pyetja më patetike e mundshme që mund t'i bëhet një njeriu normal edhe një deputeti të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Po, kryeministri ju lutem! Bilall të lutem, kryeministri e ka fjalën. Bilall, mos më vë në pozitë të keqe. Ta jap fjalën për replikë gjithsesi, po kryeministri njëherë se është kryeministër o Bilall. E kemi votuar ne vet. Kryeministër, fjala për ju! Bilall unë ta jap, po Kuvendi është kështu.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit!

Bilallit i kërkoj falje dhe nuk do ta zgjas.

Shikoni, është një marrëdhënie e ditur e definuar mes ekzekutivit dhe të gjitha sindikatave. Pra, ekziston një raport, një marrëdhënie e tillë dhe në këtë marrëdhënie ndoshta si organ më vendimmarrës edhe njëfarë gjyqtari i marrëdhënies në këto raste prapë është Parlamenti.

Pra, nuk është çudi që ndodh një diskutim pa marrë parasysh, se ne po e dimë që ministri është i Nismës e i Qeverisë e krejt, por një diskutim për një temë për orët e humbura, mendoj që nuk është i pavend.

Bindja ime është se sindikata do duhej të tregonte mirëkuptim, të kompensohen këto orë ngase është edhe në interesin e mësimit të nxënësve, edukatorëve, prindërve, po edhe të vendit tonë.

Një gjë që është me rëndësi që të shpjegohet, ministria në nivelin nacional, pra ministri Bytyqi nuk i emëron drejtorët e shkollave. Këtë duhet ta keni parasysh, kjo është kompetencë e nivelit komunal. Për shembull është në Haskuka përgjegjës për drejtorët e shkollave, ose në Deçan Bashkim Ramosaj ose nuk po e di dikush tjetër me radhë.

Dëshira e të gjithë neve është, ndoshta-ndoshta po them edhe njëherë që Parlamenti të ushtron funksionin e vet, ku i pandikuar prej këtyre marrëdhënies në raste të caktuara Sindikatë-Qeveri, mund ta jep vlerësimin e vet për një temë të caktuar.

Nuk besoj se këtu ju i bëni shërbim Qeverisë në këtë rast apo edhe sindikatës nëse i jepni ju vlerësimin se si do duhej të zgjidhej çështja e orëve të humbura. Pastaj ju mund të keni edhe plotë vërejtje për Qeverinë, për mua, për ministrin, për drejtorët, por ndoshta është mirë ta jepni një vlerësim tuajin rreth kësaj teme sepse ka të bëjë me fëmijët, ka të bëjë me shumëçka.

E vërtetë që ka pasur dyshime për marrëdhënie të dyfishta Qeveri-Sindikata edhe ka, por prapë nuk e ndryshon temën, domethënë kemi të bëjmë me fëmijët tanë, me orët e humbura edhe me fatin e këtyre fëmijëve në të ardhmen.

Ndoshta ne duhet t'i ndajmë, njëra është se a duhet t'i kërkojmë me respekt sindikatës që t'i kompensojnë orët e humbura, mos të krijohen procedentë pa kufij të orëve të humbura ngase

bëhet fjalë për fëmijët për arsimin dhe në të njëjtën kohë edhe jepni ato rekomandimet se cilat janë vërejtjet në Qeveri, në ministri e në nivelet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Bilall Sherifi ka replikë. Pastaj vazhdojmë me radhë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Po e përsëris edhe këtu në foltore, radhitja e dhënies së fjalës, gjithmonë sipas Rregullores që ju e dini shumë mirë, është që njëherë duhet të përfundojë një debat i filluar deri në replikë dhe pastaj mund ta marrë fjalën qoftë kryeministri, ministri apo kushdo tjetër që e kërkon fjalën.

Sidoqoftë, tash po kaloj në temë dhe po i drejtohem kolegut Arbër. Nëse juve ju duket turp që të ftohet një seancë në të cilën diskutohet për një çështje kaq të rëndësishme siç janë jo orët në fabrikë për të prodhuar suxhuk, po orët në shkollë për të dhënë njësi mësimore, atëherë unë me kënaqësi e mbaj këtë turp.

Por, pastaj shtrohet pyetja; kush mbetet i turpëruar këtu? Ai, ajo apo ata të cilët e konsiderojnë të turpshme një seancë ku disa kolegë 42 deputetë thërrasin një seancë ku kërkojnë nga deputetët të japin mendimet e tyre, pikëpamjet e tyre ndihmën e tyre, këshillat e tyre sesi të dilet nga kjo gjendje.

Ju e dëgjuat, në fjalën time, pra me asnjë fjalë timen nuk isha as sulmues, as fajësues, por thjesht ngrita shqetësimin sesi të dalim në përgjithësi nga kjo situatë.

Nëse kjo seancë është e turpshme, atëherë çka t'ju themi seancave tuaja që i keni thirrur, madje shumë më të kota se ne e kemi thirre. Unë ju them që sa herë ju thërrisni seancë për arsim, do të keni edhe nënshkrimet edhe pjesëmarrjen e Nismës, sepse konsiderojmë që kemi çka të japim të gjithë, pa marrë parasysh se kush e fton dhe në çfarë konteksti thirret një seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë ka Arbri!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit! Ta kemi të qartë, në aspektin objektiv nuk thash që diskutimi për orët nëpër shkolla është diskutim i turpshëm. Thashë, pyetja se a duhet të mbahet mësimi shtesë nëpër shkolla dhe e pyeta ministrin, thashë kjo pyetje është e turpshme.

Prandaj, edhe seanca si tërësi është e turpshme.

Tash nëse keni probleme, SBASHK-ministri, e të cilat, domethënë e dimë rastin e borës edhe të skllotës, atëherë nuk e kemi fajin ne. Prandaj, unë tash edhe më parë që ajo çka realisht po tregon gjendja e arsimit në Kosovë, përnjëmend është nga bora në skllotë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën, zoti Bytyqi.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet Rexhaj!

E para nuk ka ardhur ministri këtu që t'i bëhen se a duhet të kompensohen orët apo nuk duhet, sepse ne e kemi thënë me vendimin që e ka marrë ministria bazuar në obligimin ligjor për të cilin e ka.

Duhet ta keni parasysh se ministria nuk bën ekzekutimin e vendimit, e bëjnë DKA-të, gjegjësisht komunat, pra edhe ju e keni komunën të cilën e menaxhoni.

Çështje tjetër për të cilën ju thoni se çka kemi arritur në arsim. Kurdo që ju dëshironi ne mund të vijmë këtu dhe t'ju tregojmë se çfarë përpjeke të mëdha jemi duke bërë për ta ndryshuar sistemin arsimor. Konsideroj që e keni përfaqësuesin e Komisionit Parlamentar të Arsimit dhe e di se çfarë përpjeke titanike jemi duke bërë për ta ndryshuar gjendjen në arsim.

Gjendja në arsim nuk ndryshohet as për një vit dhe as për dy vite, por kërkon angazhim të shumtë dhe jo vetëm të ministrit dhe jo vetëm një ministrie, por të gjithë së bashku. Nëse nuk e keni informacionin apo nuk e dini është normale, por përgjegjësi goxha të madhe e ka pjesa e sistemit lokal. E kanë pra komunat dhe DKA-të një përgjegjësi të madhe për mbarëvajtjen dhe për cilësinë brenda sistemit arsimor.

Ne jemi të gatshëm çdoherë që t'i përgjigjemi çfarëdo kërkesë që ka të bëjë me angazhimin tonë për ndryshimin e cilësisë në arsim, shtu kësaj që u theksua më herët, për herë të parë ministri çdo tre muaj dërgon raport mbi gjendjen e arsimit në Komisionin Parlamentar dhe sa herë që Komisioni Parlamentar e sheh të arsyeshme që ne të jemi këtu, pra edhe në Parlament ne jemi këtu dhe do të diskutojmë.

Sot, mendoj që është arsyeshme të kërkohet ndihma që të dilet nga kjo situatë dhe ne të gjithë deklaruar që nuk diskutojmë për formën se a duhet të kompensohen orët apo jo, por si duhet të kompensohen dhe për një gjë të tillë jemi të hapur.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Arbër!

ARBËR REXHAJ: Ministër, ju thatë që po bëni përpjekje titanike për ta ndryshuar gjendjen e arsimit në Kosovë, ndërsa ajo çfarë ne po shohim është gjendje e vështirësuar në arsim.

Pra, organizimet sindikale të cilat e kanë pamundësuar mësimin dhe ju sot po thirrreni e luteni, pra rastin e keni sjellë edhe tek në Kuvendin e Kosovës. Pra, nuk është ashtu siç po thoni ju.

Sikur të ishte ashtu siç po thoni ju, nuk do të kishim as grevë. Nuk do të kishte as pakënaqësi të prindërve dhe të fëmijëve. Pyetje e fëmijëve, pra që ua bëjnë prindërve; kur kemi shkollë, a kemi apo nuk kemi? Nuk do të ekzistonin.

Sikur ta rregullonit komplet sistemin e arsimit në Kosovë, ne madje nuk do të ishim në këtë seancë dhe ju nuk do ta thërrisnit fare këtë seancë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që seanca është thirrur në momentin e duhur, ndoshta pak e vonuar, dhe është dashur që të debatohej shumë më herët për rolin të cilin është duke e luajtur Sindikata e Bashkuar e Arsimit apo SNASHK-u siç njihet.

Që nga organizimi i grevës e deri më tani me pengimin që të kompensohen orët e humbura të cilat janë humbur si rezultat i asaj greve.

Është interesant të dëgjojmë këtu në këtë Kuvend, dhe unë jam i bindur që është qëllimshëm, po tentohet të krijohet një konflikt mes ministrit dhe SBASHK-ut dhe unë do të ndalem pak këtu.

Ministri në të gjitha përpjekjet që nga momenti kur ka filluar të trajtohet edhe të kompletohet Ligji për Pagat, ka qenë në krye të detyrës. Ka ofruar të gjitha mundësitë. Ka mbrojtur në mënyrë institucionale dhe shumë aktive interesin e të gjithë arsimtarëve, edhe të mësimdhënësve.

Ka kërkuar dhe e kishte arritur një marrëveshje për koeficientin i cili tashmë do të jetë pjesë e Ligjit për paga.

Unë mendoj dhe dua ta ndaj mendimin se ajo marrëveshje e ministrit, ato propozime që i pati ofruar ministri për SBASHK-un dhe për Ligjin e Pagave për mësimdhënësit është penguar qëllimshëm nga politika të caktuara.

Pastaj u desh që të kalohet tri javë në greva dhe që në një moment të vjen dikush si shpëtimtar dhe të ofrojë një marrëveshje brilante, gjentelmene ku sindikalistët do të dilnin nga greva.

Edhe pse kemi kategori të mësimdhënësve, që nga klasa e parë deri në të pestën të cilët ndihen të mashtruar nga përfaqësuesit e tyre nga SBASHK-u dhe kjo temë u heshtë, sepse u ndikua nga në

fuqi, e cila unë do ta quaja që këtë udhëheqje të sindikatës, duke e shprehur mirënjohjen më të thellë për të gjithë anëtarët e Sindikatës së Arsimit ku do që janë, por jo edhe për udhëheqësit.

Këtë udhëheqje unë e identifikoj si udhëheqja e atyre “pleskavicave” ose si një aso darkash që ju shtronte Hashimi në ato darkat apo në ato ndejat.

Prandaj, ministër, vendimin për kompensimin e orëve që e keni marrë ka qenë shumë i drejtë dhe kërkoj që deputetët së paku të kursehen nga një përplasje apo nga një luftë nxitëse mes ministrit dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit.

Nuk ka luftë këtu. Këtu ka përpjekje për të ardhur tek ajo që është në interes të të gjithë neve. Të nxënësve. Të prindërve. Të mësimdhënësve. Siç e tha edhe kryeministri edhe të vendit. Pra, orët e humbura duhet të kompensohen, sepse nuk janë orë të cilat mund të krahasohen me ndonjë orë punë të llojeve apo profesioneve të ndryshme.

U dëgjuan këtu edhe disa pyetje nga disa kolegë deputetë të cilët kur po e marrin fjalën po duan që t’i japin drejtime të ndryshme partive ose t’i atakojnë partitë, qoftë në pushtet qoftë në opozitë dhe e kuptoj se po bëhet një luftë politike aty.

I nderuar Rexhaj, ku mbeti meqë nuk qenka këtu. E ngriti temën e klientelistit për partinë Nisma. Unë do t’i them se mandatin që e ka pasur Vetëvendosje në Prishtinë, ka pasur dhjetëra militantë në komunë dhe në Ndërmarrjen Banësore.

Pata dëgjuar këtu diçka shumë interesante, se ata të punësuar i ka pasur për ta ndaluar luftën apo bandat në sektorin e industrisë së ndërtimit.

Unë dua ta ngriti çështjen se ata 300 vetë, sa kanë arritur të vendosin rregull dhe norma dhe ligje në sektorin e ndërtimit në Prishtinë. Le të na e thotë dikush nga Vetëvendosja, si e kanë realizuar ata militantë të tyre, që ishin mbi 300, keqbërjen dhe të gjithë sektorin e ndërtimit në Prishtinë.

Po ashtu, më vjen keq për zotin Rexhaj i cili i ngriti disa tema që drejtorët vendosen nga strukturat politike.

Zonja Nagavci, do të ishte mirë që të na tregonte se kur ka qenë drejtoreshë në DKA në Prishtinë se sa raste i ka pasur vendosjen e drejtorëve në Prishtinë nga marifetet e saj politike? Ose nuk ka asnjë rast, le të na e thotë që nuk ka.

T’i lëmë këto çështje dhe të mos bëjmë politikë me këto gjëra, sepse janë të ulëta. Mendoj se të gjithë kur jemi në pushtet e përdorim pak politikën. Prandaj, të mos e ngremë këtë temë, por të

fokusohemi në atë se për çfarë është thirrur seanca. Seanca është thirrur që të bëjmë thirrje që ta votojmë këtë rezolutë. T'i votojmë këto rekomandime ose t'i harmonizojmë dhe ta bëjmë një zgjidhje e cila do të ishte në interes të mbarëvajtjes së procesit të mësimin.

Nuk ka asgjë tjetër që duhet të dilet nga jashtë këtij aspekti apo këtij niveli ku jemi këtu dhe për çka jemi të thirrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vetë thirrja e kësaj seance, për mendimin tim, është ikje nga përgjegjësia apo paaftësia e Qeverisë për të zgjidhur problemet banale të situatës aktuale në arsim.

Thirrja e kësaj seance është dëshmi se sa i politizuar është arsimi në Kosovë.

Në rastin konkret, brenda koalicionit qeverisës bëhet garë apo luftë se kush e komandon SBASHK-un, në vend që të thirret arsyes dhe kjo sagë apo dramë të përfundojë sa më shpejt.

Shteti ka të ardhme të sigurt kur ka arsim të mirë. Atëherë shtrohet pyetja: Në çfarë niveli të përgjegjësisë i kemi ne institucionet dhe sindikatat e arsimit? Duke pasur parasysh se në arsimin tonë ka shumë mësimdhënës me etikë të përgjegjshmërisë dhe profesionistë të mirë, por nuk mund t'i kuptoj përfaqësuesit e SBASHK-ut që deklarohen publikisht se nuk do t'i kompensojnë orët e humbura.

Ne si popull kemi përvojë që arsimi ynë ka funksionuar pa paga, nën presionin e aparteidit e të luftës dhe nuk e kemi ndalur. Kjo ka rritur shpresën për një të ardhme të këtij populli e të këtij vendi. Po sot ku jemi, ku është vullneti, etika, dija, dashuria për arsimin?

Kërkojmë që sa më shpejt t'i leni lojërat e shantazhet politike brenda koalicionit qeverisës dhe kjo situatë të zgjidhet, as prindërit nuk kanë të drejtë që t'ua mohojnë fëmijëve arsimimin apo shkurtimin e plan-programeve. Këtë duhet ta dimë të gjithë dhe duhet t'i përgjigjemi ligjit saktë, pra po e citoj jo vetëm SBASHK-u e ministria, por as vetë prindërit e fëmijëve nuk kanë të drejtë t'ua mohojnë fëmijëve arsimimin, pra as humbjen e orëve apo moskompensimin e orëve apo të plan-programeve.

Koha është që Sindikata të fillojë të kërkojë kushte më të mira për cilësinë në shkollat tona, por edhe të kërkojë përgjegjësinë nga personalitet për të arritur cilësi më të lartë në arsimin tonë.

Niveli i mësimdhënies dhe mësimnxënies është i papranueshëm në Republikën e Kosovës.

Cilësia e arsimit në Kosovë është mjerim, të gjithë e dimë. Një gjë duhet ta dimë të gjithë, se arsim të mirë nuk do të ketë duke rritur pagat. Arsim të mirë do të ketë kur do të kemi mësues të përkushtuar, profesionalistë të mirë, me vullnet të çeliktë që ky vend të ecë përpara, e që aktualisht nuk është një situatë e tillë.

Para se ta përfundoj, ta shtoj edhe këtë.

Unë e kam parasysh që personeli i arsimit ka të drejtë të kërkojë shumë përmirësim në punën e tyre, por ata duhet ta dinë që vërtet janë shtylla dhe e ardhmja e këtij vendi. Nëse vërtet mësimdhënësit tonë do të jenë të përkushtuar dhe punojnë me etikë, ne do të kemi një të ardhme të mirë dhe do të kemi një gjeneratë, e cila përgatitet për t'u qëndruar karshi sfidave që kërkon Republika e Kosovës. Në të kundërtën, kot do të derdhim mjete, derisa nuk do t'i largojmë duart dhe ta largojmë politikën nga arsimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Kujtoj se problemin që sot po e diskutojmë është një detyrë dhe problem në mes të Ministrisë së Arsimit, Sindikatave dhe Këshillit të prindërve.

Me këtë nuk desha të them se nuk e vlerësoj debatin që po bëhet sot, sepse këtij problemi duhet gjetur zgjidhjen.

Kur flasim për rolin e sindikatave të SBASHK-ut, kujtoj se ky rol ka qenë i jashtëzakonshëm në kohë më të vështira dhe është për çdo respekt dhe i tillë është vlerësuar edhe në qarqet botërore të sindikalistëve.

Po shantazhet që Sindikata ia bën tani Qeverisë janë të padrejta dhe ajo thirret vetëm për shkak të shtimit të të ardhurave dhe jo për suksesin. Asnjëherë nuk u mblodh që të diskutojë për suksesin e nxënësve, gjegjësisht për mosesuksesin, ta zëmë, në testin e PISA-s ose për kushtet e punës, për rrethanat në të cilën janë nxënësit, çantat e rënda dhe rrezikimin e shëndetit për shkak të ambientit në të cilin ata mësojnë.

Unë do të ndalem te Ligji për organizimin sindikalist, i cili shumë qartë i përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e sindikalistëve.

Grevat janë të drejtat e të punësuarve dhe ato lejohen, por jo për grupet dhe në rastet kur ato kërcënojnë grupet delikate në shoqëri, e dihet se si organizohen grevat, për shembull, si e organizon policia, ushtria, shëndetësia dhe në këtë rast dua të kujtoj si ish-sindikaliste e shëndetësisë shumë vjet para pavarësisë si i organizonin këto greva.

Me shirita të gjelbër në krah dhe duke thënë një kontribut shumë të madh në punë, gjë që ka mundur edhe sindikata të mos i humb ditët e punës dhe të mos pësojnë nxënësit, por në një mënyrë të solidarizohet dhe të bëjë greva më intelektuale, më domethënëse, me shenjat në dorë.

Prandaj, kujtoj se nuk është dashur të pësojnë fëmijët tanë.

Unë normalisht që kërkoj përgjegjësi më të madhe ndaj punëtorëve të arsimit, nuk mjafton që vetëm t'i respektojmë, por të kërkojmë edhe disiplinë në punë.

Për këtë them se duhet edhe një herë të mblidhen të gjithë faktorët që ndikojnë në këtë rrjedhën e mësimi dhe të vendosin realisht që fëmijët të mos pësojnë. Fëmijët duhet të gëzojnë një cilësi më të lartë të ofrimit të mësimi, ata duhet të mësojnë me disiplinën dhe jo t'u shërbejnë negativisht, me papërgjegjësinë, me padisiplinë dhe mosrespektimin institucional, sepse kjo është në dëm të tyre si një shembull shumë i keq.

Tek e fundit, me humbjen e orëve të mësimi në shkelim edhe të drejtat e fëmijëve, pra ligjin të cilin do ta diskutojmë shumë shpejt. Të drejtat e fëmijëve janë në rend të parë dhe sindikalistët nuk kanë të drejtë, as prindërit nuk kanë të drejtë që këto të drejta t'u mungojnë atyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Nuk është ndonjë mburrje, tek e fundit, sot të diskutojmë për këtë çështje në Kuvendin e Kosovës, kur arsimit ose çështja rreth arsimit ka ardhur deri në pikën sa ne të debatojmë tash në Kuvend për diçka që nuk do të duhej thjesht të ishte e diskutueshme.

Kur flasim për arsimin në Kuvendin e Kosovës në vend që të flasim për sistemin arsimor në përgjithësi, të flasim për nivelin e arsimit, për kurrikulat, edhe për siguri rreth arsimit, sot po flasim për diçka që duket pak a shumë, më së paku është arsimore, është teknike dhe kjo çështje ka arritur deri në nivelin sa që është komercializuar, është politizuar besa është partizuar.

Pra, këtë çështje nuk jemi duke trajtuar për t'i shërbyer arsimit, por ndoshta për t'u shërbyer disa agjendave që kanë të bëjnë me çështje krejt jashtë arsimit.

Por, po mundohem të jem pak më konkret, unë sikur shumë prej jush jam prind, i kam fëmijët në njërin nga këto shkolla, i kam fëmijët në një shkollë publike, ku drejtpërdrejt edhe te fëmijët e mi, sikur edhe te fëmijët e shumë prej jush ndikon kjo, ka ndikuar edhe greva.

Po ne ta kemi parasysh se greva është e drejtë edhe e arsimtarëve, në këtë rast, që kanë ushtruar të drejtën e tyre të ligjshme për të bërë grevë dhe përmes greve të kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre.

Nganjëherë nuk po kuptoj kur disa prej pushtetarëve flasin për fëmijët, nxënësit dhe për shkollat! Për cilët fëmijë po flasin, për fëmijët e tyre apo fëmijët tanë? Për fëmijët e tyre që i kanë për shkolla dhe kolegje private, apo për fëmijët tanë që i kemi nëpër shkolla publike dhe kjo do të shihet edhe një herë se kur flasin për fëmijët dhe për shkollat, ata detyrimin, përkushtimin duhet ta kenë prej asaj që kanë përgjegjësi për ato shkolla publike, për ata fëmijë, për ata nxënës që janë në shkolla publike.

Në ndërkohë sa ishim duke pritur këtu, na erdhi një propozim-rezolutë që shumë ndoshta prej jush e lexuat, po s'po kuptoj pse ka ardhur një propozim-rezolutë kur në fund thotë brenda javës së ardhshme të gjendet një mënyrë. Nëse ne do të duhet të diskutojmë, do të duhet të ishim më konkretë edhe në propozim-rezolutë, ta gjejmë një mënyrë.

Me fjalën ose me votimin e kësaj rezolute eventualisht që nuk pres të votohet, ta gjejmë një mënyrë, çfarë i bie? Ta gjejmë një mënyrë për të krijuar shans dhe mbi këtë ta gjejmë një mënyrë të kemi veprime partiake politike dhe klanore apo vërtet ta gjejmë një mënyrë që të dalim nga kjo situatë? Për fat të keq, unë kam dyshim që është e para.

Por, arsimtarët kanë të drejtë për ta ushtruar të drejtën e tyre dhe zëvendësimi i ditëve të punës, mos harroni, zëvendësimi i ditëve të punës që po quhen të humbura në grevë, është i paligjshëm.

Kompensimi nuk do të thotë zëvendësim i ditëve të punës, kompensim mund të ketë edhe duke mos i zëvendësuar ditët e punës dhe unë si një deputet që kam po ashtu përgjegjësi publike, do të kërkoja që t'ua besoni më shumë që këtë kompensim, jo zëvendësim të ditëve të punës, t'ua besoni më shumë arsimtarëve, menaxhmentit të shkollave dhe ata do të dinë si do ta kompensojnë atë çfarë me të vërtetë nxënësit tanë nuk e kanë marrë gjatë kohës së grevës. Megjithëse unë nuk mund ta quaj që janë ditë të humbura, por janë ditë greve.

Kështu që, më së miri se si t'i kompensojnë e dinë ata, të cilët përmes grevës kanë ushtruar të drejtën e tyre për grevë.

Edhe një herë, zëvendësimi i ditëve të punës, edhe nëse ne do të donim, është drejtpërdrejt shkelje ligjore ndaj të drejtës për të ushtruar grevën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Më shumë sqarim, se sa replikë me kolegun Selimi.

Kjo është lexuar në fillim, kur ai me sa di s'ka qenë fare në seancë, dhe pastaj ia kam dorëzuar administratës për ta shpërndarë te deputetët, në mënyrë që deputetët apo grupet parlamentare që mund të kenë ndonjë propozim, ndonjë ide për ta përfshirë në rezolutë, sepse fakti që është propozim-rezolutë dëshmon që është për t'u diskutuar dhe jo përfundimtare.

Dhe, jo të gjendet një mënyrë për ta, por ata ta gjejnë, jo ne ta gjejmë, pra ministria, SBASHK-u, po e lexoj, nuk di a me qëllim a pa qëllim, ta lexoj krejt fjalinë. Unë po e shfrytëzoj rastin ta lexoj krejt fjalinë për t'u kuptuar më mirë nga ata që janë duke dëgjuar.

“Kuvendi i Kosovës kërkon nga Ministria e Arsimit, SBASHK-u dhe drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit që urgjentisht brenda javës së ardhshme të gjejnë mënyrën për të mbajtur orët mësimore të humbura gjatë grevës së këtij viti”.

E se çka kuptojmë me orë mësimore, kam sqaruar sërish në fillim të fjalës sime, të cilën nuk di a ka qenë Rexha, s'e nuk e kam parë. Pra, këtë e mora më shumë për të sqaruar se çka nënkupton kjo dhe kjo propozim-rezolutë ka ardhur për faktin se një vendim që është marrë i ligjshëm, natyrisht nga ministria, nuk po zbatohet. Pra, në funksion të dhënies së kontributit që çështja të zgjidhet, të bëhet ai kompensimi që po thotë dhe kolegu, mënyrën se si do të bëhet ai kompensim, do ta vendosnin ministria, SBASHK-u dhe drejtorët e drejtorive, përmes të cilës do të zbatohet pastaj ky vendim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Selimi e ka fjalën, kundër-replikë.

REXHEP SELIMI: Edhe unë nuk do ta bëj kundër-replikë, por në shërbim të sqarimit, siç na tha kolegu. Unë prapë po i jap vetes të drejtë që kjo propozim- rezolutë nuk thotë diçka konkrete. Pra ju po kërkonit edhe nga Ministria e Arsimit, edhe nga SBASHK-u, edhe nga drejtoritë e drejtorive nëpër komuna për arsim që brenda një jave pra, brenda javës së ardhshme ta gjejnë mënyrën për të mbajtur orët e mësimit.

Pyetja ime është, të cilën do të doja që mund të ma ktheje si përgjigje, nuk më prish punë nëse kërkon prapë fjalën: A vërtet ju nuk e dini mënyrën, a? Ju si sponsorizues, po flas. Ti si kolegu imi, nëse ke sponsorizuar këtë, a e di ti, së paku, se cila është mënyra, të cilën do të duhej t'ia preferoje tash Kuvendit dhe Kuvendi pastaj mund t'i ndihmonte? Ose edhe si subjekt politik që udhëhiqni me arsimin, a e dini, pra, ju mënyrën paraprakisht, para se ta kërkonit prej Kuvendit një gjë të tillë?

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se podpredsedniče Parlamenta!

Poštovani premijeru,

Poštovani ministre, kolege poslanici,

Poštovani građani,

U potpunosti podržavam današnju debatu koja je posvećena novo nastaloj situaciji u našem obrazovanju u vezi odbijanja naknade izgubljenih časova prosvetara tokom 3. nedelje štrajka od 14. januara do 1. februara 2019. godine, odnosno ne realizacija nastavnog plana i programa Ministarstva obrazovanja. I moje je mišljenje da Ministarstvo mora hitno reagovati u vezi ove problematike, ali pre svega u interesu naših učenika, a ne u interesu jedne političke partije ili jednog udruženja. Ovo je nacionalni problem, moramo i svi smo u obavezi da ga zajedničkim snagama rešavamo za to što su velike posledice nanete učenicima u nastavi već stvorene su zbog ne održavanja i izgubljenih nastavnih časova što se sada reflektuje i na njihove loše ocene u drugom periodu nastave za to što ne mogu pratiti novi plan i program Ministarstva obrazovanja.

Velika je šteta naneta gospodu učenicima prvog razreda 15. izgubljenih radnih dana tokom čitavog štrajka ugrozili su učenje nekoliko slova abecede, i sada je to teško da se ispravi s obzirom na njihovu uzrast i na njihove godine. Drugi razred takođe u tom vremenskom periodu uči tablicu množenja, takođe jedan od velikih problema. Peti razred zbog njihovih novih nastavnih jedinica, velike posledice su kod učenika devetog razreda ili mini mature ali pre svega kod naših maturanata koji završavaju srednje školsko vaspitanje i imaće dodatne teškoće na maturskom ispitu.

Poštovani ministre trebate poštovati i uključivanje i reakciju roditelja u ovom procesu koji najvišu brinu za svoju decu i pronaći najbolji mogući rešenje za učenike, a tek onda za prosvetne radnike, jer ćemo posle toga naići na drugi problem u ovom Parlamentu.

Gospodo poslanici niko danas ne govori o lošem uslovima po našim školama, o nedostatku udžbenika, o kvalitetu nastave, o vrednovanje prosvetnih radnika, o lošim rezultatima naših studenata, o globalnom lošem obrazovnom sistemu, o pedagoškoj etici edukativnog sistema. Milim vas budimo svi oprezni šta i kako govorimo u ovom Parlamentu za proces obrazovanog sistema, a pravo štrajka prosvetara je demokratski proces jer oni imaju pravo na to, ali ne na štetu učenika i naših studenata i obrazovanja treba hitno reagovati u rešavanju ovog problema.

Poštovani ministre obrazovanja, gospodin Bytyqi, vi kao ministar imate legitimnog pravo da poštujuete zakonske procedure bez bilo kakvog ucenjivanja i pritisaka sa strane, a proces povećanja plata prosvetnih radnika doneo je ovaj Parlament i čekamo realizaciju toga. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht se kur diskutohet për një çështje shumë të ndjeshme është problem të qëndrosh indiferent dhe unë, në këtë rast, më shumë do të flas si qytetar dhe si deputet, pasi kolegët, veçanërisht kryetari i grupit e ka dhënë edhe mendimin partiak. Po e them si qytetar dhe deputet, sepse do të përdor shprehje jo shumë të zakonshme dhe parlamentare për një situatë, të cilën tashmë të gjithë jemi të bindur se një grup ‘debillash’, të udhëhequr nga “kryedebilli” që thirret si kryetar i Sindikatës, ka vënë në siklet këtë shoqëri.

Fillimisht duhet të them se arsimtarët në mënyrë shumë të padrejtë, por gjithsesi domethënë për shkak të situatës në të cilën kanë pasur kërkesat e kanë arritur objektivin e tyre në rritjen e pagave, edhe pse po e ripërsëris nuk ka qenë kërkesë e drejtë dhe ka qenë kërkesë e nxitur politikisht. Detyrimisht shtrohet një pyetje në rast se ata e kanë arritur objektivin, çka do të bëhet me nxënësit, a do të arrijnë nxënësit objektivin për të cilën shkojnë në shkollë? Dhe, më e keqja është se në kohën kur po mbahet kjo seancë, ky “kryedebill”, ky injoranti i llojit të veçantë, i sojit të veçantë, del thotë se ministri me qëndrimet në përputhje me ligjin dhe me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka thotë “do me ua shkelë të drejtat fëmijëve”. Domethënë, ky “debill” që e ka bërë kaos gjendjen në arsim nuk ua ka shkelur të drejtat e fëmijëve dhe nuk ua shkel, ndërsa ata që zbatojnë ligjin dhe veprojnë në përputhje me përgjegjësitë po ua shkelkan të drejtat!

Megjithatë unë dua të dal në mënyrë kronologjike se si kjo Sindikatë e udhëhequr nga një injorant i sojit të veçantë, me një grumbull injorantësh rreth vetes, duhet së pari të solidarizohen me kolegët e vet, për të cilët po më vjen keq, rreth 30 mijë intelektualë të identifikohen me një njeri që veç kur e sheh si fotografi, është ofenduese, kjo është pa koment. Sido që të jetë, ai duhet të tregojë me vepër se është me punëtorët e arsimit, por jo vetë ta marrë rrogën më të madhe se të ministrit e deputetit e shumë zyrtarëve të lartë të shtetit, e çdo ditë shet mend para opinionit. Në momentin që “kryedebilli” i Sindikatës së Arsimit ka dalë dhe ka thënë se për vazhdimin e mësimin vendosim ne a e mbajmë, a s’e mbajmë dhe kur e mbajmë, kjo tregon për nivelin e tij edhe intelektual, edhe njerëzor, në të cilën situatë kanë ardhur domethënë një pjesë e rëndësishme e shoqërisë sonë, siç është domethënë armata e intelektualëve, të cilët kanë përgjegjësi për t’u dhënë dije fëmijëve që janë e ardhmja e këtij shteti. Unë jam shumë i befasuar ose po mundohem të rri indiferent ndaj asaj që tash është shumë publike, Sindikata është dorë e zgjatur e Partisë Demokratike dhe këtë nuk ka koment, se aty ku ka filluar greva e qëllimshme për të krijuar turbulencë në qeverisje, ku edhe vetë PDK-ja është, ka përfunduar pikërisht në zyrën e kryetarit të PDK-së, i cili me shkop magjik, si “profet” e zgjidhi problemin dhe sot para kësaj seance me të njëjtin stil, si manipulator ekspert me masat, domethënë doli e paralajmëroi se çështja do të zgjidhet.

Kjo më tash ia ka hequr maskën kësaj Sindikate, e cila është politike dhe për fatin e keq një numër të madh të punëtorëve të arsimit, si kope pas bariut i ka çuar dhe i ka shitur për një pjatë prej 5 qofteve për vite të tëra para Hashim Thaçit, i cili është personi më përgjegjës jo vetëm për

situatën në arsim, por edhe për katastrofën që ka përfshirë jetën qytetare në Kosovë në përgjithësi. Sindikata, unë mendoj përpos pagave dhe lojërave të fëlliqura politike që nuk janë në domenin e tyre, ato duhet të merren vërtet me çështje sindikale dhe me gjendjen në arsim. Unë do t'i marr nja 2-3 shembuj për të qenë më i qartë se në cilën situatë gjendet Kosova, arsimi dhe në cilin komoditet është ky grumbull i 'debillëve', të cilët thirret në emër të sindikatave. Ju përfaqësues të sindikatave duhet ditur se në disa fshatra të Kosovës kanë mbetur nga 5 nxënës e 7 mësues. Ose në një fshat atje ku pas luftës ka pasur 800 nxënës, sot ka mbetur në 320 nxënës. Ju edhe mund të kërkoni t'u rriten pagat, vetëm në rast se ju bëheni pjesë e lojërave të pista të individëve të caktuar që janë në krye të institucioneve dhe që e kanë fundosur perspektivën e këtij vendi, ju pas pesë vjetëve bankave të zbrazëta do t'u jepni mësim!

Mua më vjen keq për një numër të arsimtarëve që mendojnë që një pjesë mund edhe duke përcjellë këtë seancë, i pyes ku i kanë fëmijët e tyre? Ku i kanë fëmijët një numër i madh i arsimtarëve? Krejt u kanë ikur në Perëndim, duhet ta dinë arsimtarët se në rast se ne sillemi kështu me shtetin, edhe atyre fëmijëve që janë duke u dhënë mësim, pas disa vjetëve do t'i kenë në Perëndim dhe unë në këtë rast me këtë po dua t'i thirrë mendjes së kthjellët në këtë shoqëri, t'i kthehem realitetit, Kosova nuk është në komoditetin të shesë pallavra çifti i "kryedebillit" në emër të Sindikatës dhe thjesht të mjegullojë edhe më tepër situatën e rëndë ekonomike dhe politike.

Ju vërtet e keni arritur një qëllim në mënyrën më të padrejtë, por ju e keni shkatërruar Kosovën, ju vërtet do ta merrni rrogën 100 euro më tepër, por ju e keni shkatërruar të ardhmen e këtij vendi dhe unë jam shumë i bindur që kjo ka për t'iu hakmarrë juve dhe neve, sepse në fund të fundit, ju nuk mund të qëndroni indiferentë në këtë situatë që po ndodh në Kosovë. Duke i rritur pagat, e keni shkatërruar ekonominë e këtij vendi në mënyrë jo të drejtë. Ata që ju kanë këshilluar, e kanë pasur për vota, unë nuk po dua ta marr njërin nga kolegët shembull, edhe asnjë votë të tërë nuk e dua për të mos e thënë të vërtetën.

Lojërat e pista me sindikatat e arsimit duhet të ndalen e t'i kthehem gjendjes reale dhe të merremi me problemet jetike, me të cilat po përballët shoqëria jonë. E di që dikujt mundet të mos i pëlqejë, e di që dikush tash është i shtrirë në shtrat në vend se të jetë në orë të mësim, e duke shkruar ese e elegji nëpër 'fejsbuka' e duke i sharë njerëzit e politikës e duke e adresuar fajin aty ku s'është. Jo që politika s'i ka fajet, se politika është aktori kryesor i të gjitha dëmeve që i kanë kushtuar këtij vendi, veç të mos harrojmë, krejt ne që jemi këtu në Parlament, jemi rezultat i votës së tyre dhe nesër jam i bindur që po të dalim në vota, 90% prapë këta kanë për t'u zgjedhur dhe prapë ata do të fillojnë përmes poezive dhe elegjive nëpër rrjetet sociale dhe në 'paçavura elektronike' informative të derdhin lot krokodili. Sido që të jetë, unë po shpresoj se ministri në përputhje me përgjegjësitë do të veprojë, turpi do t'u mbetet atyre që po manipulojnë me arsimtarët dhe dëmi po shkon në adresë të fëmijëve tanë, fëmijëve të Kosovës, në adresë të familjeve tona.

Besoj se, për të satën herë po e them, është momenti të kthjellemi e t'i kthehemi realitetit dhe problemeve jetike, me të cilat po përballohet shoqëria, sepse konsideroj se në rast se tash rrimë indiferentë ndaj këtyre zhvillimeve, nesër do të jetë vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë po flas në emër timin meqë qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës e tha znj. Luljeta Veseli dhe po e them që njëra prej nënshkrueseve të kësaj kërkesë për seancë të jashtëzakonshme që na ka ardhur nga Nisma prandaj, e konsideroj totalisht shqetësuese deklaratën që e tha kolegu im. Është e rëndë që në një seancë e cila thirret për t'u munduar që të gjendet një zgjidhje, e prej të cilës pësojnë më së shumti nxënësit e shkollave, ne të lëshohemi në etiketime dhe në fyerje personale dhe individuale. Ishte Kryetari i Kuvendit zoti Veseli që sot në hapje të kësaj seance u deklarua që Komisioni bashkë me përfaqësues të SBASHK-ut dhe të Ministrisë të bëhen bashkë në mënyrë që të arrihet që të gjendet një zgjidhje.

Ne nuk jemi këtu për të fyer dhe të etiketuar persona, individë të caktuar për mënyrën sesi ata duken. Kjo është e turpshme dhe nuk duhet të ndodhë në këtë Parlament që ne të lëshohemi në një gjuhë që nuk i takon këtij vendi. Sot po na dëgjojnë prindërit, po na dëgjojnë gjenerata të tëra që i kanë fëmijët në shkolla, prandaj ky Parlament njëherë e përgjithmonë duhet ta ndalë këtë diskurs, tepër të ulët e tepër fyes për qytetarët e vendit.

KRYESUESI: Replikë. Kundër-replikë se replikë bëri Blerta. Kundër-replikë zoti Berisha.

ZAFIR BERISHA: Shiko!

Unë megjithatë jam shumë i vetëdijshëm për shprehjet që po i them, edhe natyrisht në rast se dini të lexoni mes rreshtave, këto po i them i revoltuar nga situata në të cilën e ka sjellë kjo sindikatë dhe ky "kryedebil" për mendimin tim. Në fund të fundit, ky është mendimi im personal. Unë mbaj përgjegjësi për atë që them. Sesi sillem unë në Kuvend, kjo është çështje krejt tjetër, por sido që të jetë, nuk ka të drejtë askush të ma mohojë mendimin dhe qasjen time për një problem të caktuar. Në fund të fundit, duke u treguar me një politikë ngreh e mos këput, e kemi pru, e keni pru në fakt situatën këtu ku jemi dhe sot ju edhe mund ta mbron. Mirëpo, nuk mbrohet situata e kësaj natyre, e cila ka ardhur si rezultat i atyre injorantëve të sojit të veçantë që janë në krye të Sindikatave dhe manipuloni si top futbollit me ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolege e kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Pa dashur të përsëritem dhe atë që e thanë veç parafolësit, pra kolegët e mi të nderuar, dhe me faktin se dy koleget e mia nga Grupi Parlamentar 6+ u deklaruan më herët, mirëpo për fat të keq shumica, apo pjesa dërmuese e kolegëve nuk patën rast t'i dëgjojnë, sepse u ka munguar pajisja apo përkthimi, unë e ndjej si obligim që ta paraqesë qëndrimin e Grupit Parlamentar 6+ në gjuhën shqipe, me qëllim që ta kuptojnë të gjithë, normal për ata që s'e kanë kuptuar.

Atëherë, dëshiroj të shpreh mendimin tim lidhur me këtë seancë të jashtëzakonshme, e cila ka të bëjë me kompensimin e orëve të humbura të mësimit gjatë grevës trijavore të mësimdhënësve të shkollave filllore dhe të mesme në Kosovë.

GP 6+ dhe unë personalisht mendoj dhe jam i bindur që nëse e marrim në konsideratë mirëqenien e nxënësve dhe fëmijëve tanë, dhe sadopak mendojmë për ta, të cilët i konsiderojmë jo vetëm e ardhmja, po edhe e tashmja e shtetit të Kosovës, por gjithashtu duke marrë për bazë dhe plotësimin e kërkesës së SBASHK-ut për rritjen e koeficientit të pagës, atëherë me pa mëdyshje më duhet të them që plotësisht më duhet të përkrahë vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe zoti Bytyqit për kompensimin e orëve të humbura të mësimit gjatë grevës trejavore të mësimdhënësve të shkollave filllore dhe të mesme në Kosovë. Sidomos, tani pas plotësimit të kërkesës së SBASHK-ut për rritjen e pagave. Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se dorëzimi i padisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga SBASHK-u ndaj vendimit të Ministrisë së Arsimit është veprim i ngutur dhe sipas mendimit tonë i cili dërgon në një qorrsoak dhe nuk sjell zgjidhje, por i thëllon edhe më shumë mosmarrëveshjet mes MASHT-it dhe SBASHK-ut. Kjo mosmarrëveshje ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut do të ndikojë negativisht edhe te nxënësit të cilët pa asnjë faj janë pre e kësaj mosmarrëveshje.

Prandaj në fund, pa dashur të përsërisë ato që veç tashmë u thanë disa herë, i lusim të dyja institucionet, që sa më shpejt të merren vesh për hir të mësimit të nxënësve tanë, për hir të së ardhmes së tyre, që orët e humbura, orët e mësimit të kompensohen sepse do të kishin efekt pozitiv dhe do të ndikonin në ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsimor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje ministra,

Përshëndetje kolegë të nderuar deputetë,

Përshëndetje të gjithë punëtorëve të arsimit, por edhe të gjithë përfaqësuesve të sindikatave të arsimit, të gjitha sindikatave!

Nuk është hera e parë që kërkojmë debat dhe pastaj mbajmë qëndrime shumë të ngushta politike, qëndrime shumë personale, përdorim gjuhë fyese dhe sjellim këtu në foltoret tona, pranë qytetarëve tanë, një diskurs që realisht nuk i shërben fare qëllimit për çfarë është thirrur.

Qëllimi ka qenë shumë i qartë. Unë kam biseduar me z. Sherifi dhe po shihet që tash kemi dalë jashtë asaj çfarë është thirrur kjo seancë. Të gjithë e dimë që është në proces gjyqësor dhe të gjithë e dimë që është e ndaluar të ndërhyjmë në një proces gjyqësor. Po kemi dashur ta shprehim mendimin tonë dhe të ofrojmë zgjidhe dhe t'i mbështesim të gjitha palët, po më së shumti ata të cilët humbin më së shumti, dhe këta janë nxënësit tanë. Dhe në këtë aspekt, e kemi ne, tash kryeministri e ka thirrur një seancë që është menjëherë pas saj, që kur kemi dashur, Ligji për ndalimin e lojërave të fatit, ka pasur edhe aty manipulime nga propozuesit, që të bëjnë, ta bëjnë këtu një festival, pastaj të ndahemi të gjithë dhe të mbetet faji i Qeverisë dhe të gjithë neve këtu. Ka qenë pikërisht Kryetari i Kuvendit, po edhe ministri i Financave, që të dy vijnë nga PDK-ja, bile Kryetari i Kuvendit është edhe kryetar i PDK-së, kanë insistuar deri në fund që të merret një rezolutë, të nxirret një rezolutë, e cila ia mundëson Qeverisë ta nxjerrë këtë ligj që do ta votojmë tash më vonë. Dhe, rastësisht e ka propozuar idenë një deputet i Nismës, i cili sapo u fut në sallë dhe na ka nxjerrë nga gjendja çfarë është.

Pse po e them këtë? Po të kishim qenë të interesuar t'i ndihmojmë nxënësit, t'i ndihmojmë arsimitarët, ta ndihmojmë ministrin, ta ndihmojmë sindikatën, e kishim kryer brenda një ore, duke u prononcuar, duke folur, duke mbajtur qëndrim përfaqësuesit e shefave të grupeve parlamentare. Po sipas të gjitha gjasave po del që nuk ka qenë ky qëllimi. Qëllimi ka qenë si zakonisht të flasim për politikë, të mbajmë qëndrime politike, të themi që me një anë sindikata është ashtu ose kështu, në anën tjetër, të flasim është ministri ai i cili i ka të gjitha fajet. Në anën tjetër, deklarohen deputetë që ne nuk duhet të merremi me sindikata dhe çështje sociale, se jemi parti të djathta ose qendër e djathtë, çfarë është CDU-ja, çfarë është kancelarja zonja Merkel, e cila më së shumti është marrë me çështjet sociale. Dhe, kjo është për t'u çuditur. Vërtet kjo është për brengosje. Ku jetojnë këta njerëz? Si thuhet, iu pengon druri për ta parë pyllin. U pengon një çështje e vogël për ta parë tërësinë e çështjes. Kë përfaqësojnë këtu? Dhe thirren dhe mendojnë se janë si të tillë, ose tentojnë ta bindin veten.

Dua të them që kryetari i PDK-së dhe Kryetari i Kuvendit është edhe kryetar i koalicionit, dhe ky koalicion e ka votuar edhe këtë ministër që është aktualisht këtu dhe do të duhej ta kemi parasysh të gjithë, po sidomos deputetët e koalicionit qeverisës. Dhe në kuadër të kësaj, dua të them edhe një çështje që ka besoj rëndësi në këtë rast. Kryetari i PDK-së edhe Kryetari i Kuvendit i takon të gjitha grupet e interesit, i takon edhe sindikatat. Është marrë dhe merret edhe me mësimdhënësit, edhe me arsimin, edhe me çdo gjë tjetër dhe është e drejtë e tij dhe është obligim i tij. Edhe në këtë rast, u mundua dhe është munduar të gjejë zgjidhje, dhe zgjidhja është ajo e cila është më e mira për nxënësit dhe është më e mira për Ministrinë e Arsimit dhe është më e mira për sindikata. Nuk do të duhej që të anatemohej sindikata. Ajo është pjesë e qenësishme e

shoqërisë. Sidomos e shoqërisë çfarë jemi ne, po kemi nevojë shumë që të angazhohemi dhe të merremi me çështje sociale, kur kemi nevojë të angazhohemi e të merremi me çështjet e të drejtave të punëtorëve, pavarësisht cilit sektor janë ata.

Dhe, do të duhej që në këtë aspekt, vërtet të jemi të kujdesshëm, të mos flasim fjalë që janë fyese, pa asnjë arsye. Dhe me një qëllim ta devalvojmë këtë debat, dhe ta devalvojnë qëllimin e kësaj seance të jashtëzakonshme e cila është thirrur për ta lehtësuar procesin, për t'i mundësuar atyre që do ta marrin vendimin që sa më shpejt ta marrim vendimin. Dhe vendimi duhet të merret në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Sindikatave. Dhe, kuptohet që në asnjë situatë dhe asnjë moment nuk do të duhej të dalin humbës nxënësit. Pra, askush. Dhe, kjo është esenciale.

Unë këtu kisha kërkuar edhe një herë që në seanca të tilla dhe në raste të tilla, kur ne vërtet kemi qëllim që të lehtësojmë një proces, që të marrim një vendim, të mos luajmë lojëra politike, pavarësisht se kush i bën ato. Ne e kemi thirrur edhe një herë këtë seancë për ta lehtësuar këtë proces. Ka pasur kundërshtarë të kësaj thirrjes së kësaj seance, dhe ka pasur rezerva të thirrjes së kësaj seance, dhe realisht nga debati i deritashëm po del që kanë pasur të drejtë. Secili nga deputetët flet për një çështje. Tash drejtoresha e Arsimit që ka qenë për katër vite tash s'është këtu. Tash flet për drejtorë politikë, po vërtet është absurde. Po vërtet nuk është e moralshme. Kur dihen që të gjithë, gati se pa përjashtim, përkundër asaj që deklarohen ndryshe, bëjnë emërime të tilla.

Dhe, fundi i fundit, ministri është person politik, po nuk do të duhej që ta bëjë një vendim, ta marrë një vendim, dhe ta bëjë një veprim në dëm të cilësisë, në dëm të atyre të cilët mund të ofrojnë diçka, që është më e mirë dhe që mund ta avancojë një proces. Në këtë rast, arsimit është shumë me rëndësi dhe shumë me peshë.

Kisha bërë thirrje edhe një herë që seancat e këtilla kur ne mendojmë se janë të domosdoshme, vërtet të kemi kujdes se çfarë po deklarojmë dhe si po pozicionohemi. Esenca është që duhet ta ndajmë, a duam ta mbajmë një seancë dhe të fyejmë njëri-tjetrin, dhe të fyejmë ata të cilët sot na përcjellin me vëmendje, në daç të shtrirë në kauç, në daç këtu në sallë, në daç atje lart. Po e përcjellin se duan ta dinë çfarë do të vendosim ne. Apo duam që vërtet të përplasemi me njëri-tjetrin, kur kemi hapësirë edhe mundësi të tjera dhe nuk kemi nevojë të thërrasim seanca të jashtëzakonshme se mund t'i bëjmë këto edhe në seanca të zakonshme, pavarësisht se fyerjet as nuk do të duhej të jenë këtu prezente, as në këtë sallë, po as kashtë saj. Dhe çka do të duhej të kërkohej, që vërtet të ketë një vetëdije jashtëzakonisht të lartë që këto njëherë e përgjithmonë të mos kenë vend këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën përfundimtare e ka zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit zoti kryesues!

Së pari, unë jam këtu përfaqësues jo i Nismës, po i 42 deputetëve. Kur kam folur, që në fillim besoj që e keni parë që nuk i jam drejtuar seancës në emër të Nismës, po në emër të 42 deputetëve, qofshin ata nga PDK-ja, qofshin nga Nisma, qofshin nga PSD-ja. Nuk e kam keqpërdorur faktin që ju keni besuar në idenë të cilën unë e kam shtruar së pari brenda Nismës pastaj së bashku me juve, duke përfshirë së pari, madje kam biseduar me zotin Reçica dhe pastaj edhe me të PSD-së. Ua kam shtruar idenë që të bëjmë seancë të jashtëzakonshme, meqë çdo kund debatohet për këtë çështje, pse të mos debatohet edhe në Kuvend. Kjo ka qenë ideja fillestare. Nuk ka pasur qëllim të keq as negativ dhe as për ta sulmuar dikë.

E keni parë deputeten Balaj-Halimaj që ka folur në emër të Nismës. Të gjitha fjalët tjera që i kanë folur, cilido deputetët mbanë përgjegjësi personale, morale e politike për mënyrën sesi i drejtohet edhe si sheh gjërat. Kjo është sa për fillim për t'u sqaruar.

Tash më lejoni që të dal te pjesa e rezolutës, propozim-rezolutës. Ka ardhur veç një propozim nga një kolege aty që e pata afër që jo nga java e ardhshme, por marrëveshja të gjendet brenda kësaj jave, në mënyrë që nga java e ardhshme të fillojë zbatimi i marrëveshjes së mundshme që mund ta arrijmë.

Pra, presim që së paku të arrihet marrëveshje mes ministrisë, SBASHK-ut dhe në bashkëpunim edhe drejtoritë komunale të arsimit.

Tash, më lejoni ta sqaroj se pse, ngase kishim disa paqartësi rreth asaj se çka nënkupton pika tretë (3).

Unë do të nisëm nga pika e parë (1) e konstatoj gjendjen dhe thotë se: Greva trejavore në arsim në këtë vit ka pasur për pasojë humbjen e shumë orëve të mësimi, rrjedhimisht edhe të shumë njësive mësimore të parapara me planprogram të Ministrisë së Arsimit.

Pra, duke i pasur parasysh faktet në terren, Kuvendi i Kosovës përmes rezolutës apo përmes një deklarata si të doni mund ta quajmë, konstatoj se plotësimi i planprogramit mësimor i paraparë nga Ministria e Arsimit është i domosdoshëm dhe si i tillë i paalternativë.

Dhe pika e tretë (3) te paqartësitë që ishin, pra unë mendoj që pika e tretë është derivat i këtyre dy të parave - Kuvendi i Kosovës kërkon nga Ministria e Arsimit, SBASHK-u dhe drejtorët e Drejtorive Komunale për Arsim, që urgjentisht ta përmirësojë brenda kësaj jave të gjejë mënyrën për t'i mbajtur orët mësimore të humbura gjatë grevës së këtij viti. Pra, nuk ka asgjë të paqartë.

Ne si Kuvend nuk po urdhërojmë askënd. Ne si Kuvend po nxjerrim një rezolutë, ku po kërkojmë, po konstatojmë gjendjen, po konstatojmë faktin se njësit mësimore, mësimet duhet

plotësohen dhe kërkojmë nga aktorët që janë të përfshirë që ministria për nga ligji, sindikata gjithashtu për nga ligji dhe përfaqësuesit e arsimitarëve edhe nga drejtoritë komunale që të ulen dhe së bashku ta gjejnë mënyrën.

Pra, njëri nga mënyrat ka qenë ajo që e ka paraparë ministri, po nëse sindikata si përfaqësuese e mësimitdhënësve ka ndonjë ide për ndonjë mënyrë tjetër të zëvendësimit të atyre orëve, të kompensimit të atyre orëve, atëherë unë jam shumë i sigurt që ministria do të jetë e hapur që së bashku, brenda një procesi qoftë ditor, qoftë brenda këtyre dy ditëve të arrijë tek një zgjidhje e përbashkët.

Unë nuk besoj që ministri, edhe pse ka pasur të drejtë ligjore ta marrë atë vendim, siç u tha këtu madje edhe nga kolegët deputetë, në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit për Arsim, nuk besoj që është i ngurtë dhe të ngulë këmbë në egon tij personale se, ose do të bëhet kështu ose nuk do ta tërheq vendimin.

Unë jam shumë i sigurt që me një bashkëpunim mes këtyre aktorëve, do të gjendet zgjidhja që brenda javës së ardhshme të fillojë kompensimi i orëve mësimore të humbura. Pra, po e ritheksoj, bëhet fjalë për mësim, për njësi mësimore dhe jo për tulla e beton. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kuorum për votim të rezolutës nuk ka. E lëmë për herën tjetër. E konsideroj këtë seancë të mbyllur, të përfunduar.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*